



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
BASHKËKOHORE**

PROGRAMI STUDIMOR: DIPLOMACI

TEZA E MAGJISTRATURËS

**“Roli i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në
Diplomaci”**

**Kandidati:
Bekim FAZLIU**

**Mentori:
Prof.Dr. Agron RUSTEMI**

Tetovë, 2021

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	4
-----------------------	---

-HYRJE	5
---------------------	---

KAPITULLI I: DIPLOMACIA PARLAMENTARE- ASPEKTET TEORIKE DHE SHFRYTËZIMI I TYRE NË PRAKTIKË	8
--	---

1.1 Nocioni dhe historiku i Diplomacisë Parlamentare.....	10
---	----

1.2 Impakti i Diplomacisë Parlamentare në Marrdhëniet Ndërkombëtare.....	11
--	----

KAPITULLI II: PARLAMENTI I RMV-SË –ROLI I TIJ NË “DIPLOMACINË E INFLUENCËS”	13
--	----

2.1 Diplomacia Parlamentare, sfidë për Parlamentin e RMV-së.....	14
--	----

2.2 Raportet mes Diplomacisë Parlamentare dhe asaj Tradicionale-“Zyrtare”.....	16
--	----

2.3 Integrimet Rajonale dhe Diplomacia Parlamentare.....	20
--	----

2.4 Përparësitë, mundësitë dhe “rreziqet” e Diplomacisë Parlamentare.....	21
---	----

KAPITULLI III: ROLI ,KAPACITETET DHE AKTIVITETI DIPLOMATIK I DELEGACIONEVE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË	23
--	----

3.1 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (AP KE)	24
---	----

3.2 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së, në Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë (AP OSBE).....	26
--	----

3.3 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (AP NATO).....	27
---	----

3.4 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim.....	28
--	----

3.5 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Unionin Interparlamentar (UIP).....	28
--	----

3.6 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Europës Qendrore (DP IEQ).....	29
---	----

3.7 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Mesdheut (AP e Mesdheut)	29
---	----

3.8 Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Procesit për Bashkëpunim në Europën Juglindore (AP PBEJL)	30
--	----

3.9 Delegacioni i Seksionit të Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë (APF).....	31
---	----

3.10 Grupet parlamentare për bashkëpunim.....	32
---	----

KAPITULLI IV: ROLI DIPLOMATIK I TRUPAVE PUNUES TË PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT NACIONAL PËR EUROINTEGRIME.....	33
4.1 Komisioni për politikë të jashtme.....	34
4.2 Komisioni për çështje evropiane.....	34
4.3 Këshilli nacional për eurointegritime.....	35
KAPITULLI V: AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË.....	37
5.1 Prezantimi i të dhënave nga aktivitetet ndërkombëtare të Parlamentit të RMV-së....	37
5.1.1 Aktivitetet multilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2018.....	39
5.1.2 Aktivitetet bilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2018.....	45
5.1.3 Aktivitete ndërkombëtare BE- Parlamenti i RMV-së për vitin 2018.....	48
5.1.4 Aktivitete të tjera ndërkombëtare për vitin 2018.....	50
5.1.5 Aktivitetet multilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2019.....	53
5.1.6 Aktivitetet bilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2019.....	59
5.1.7 Aktivitete ndërkombëtare BE- Parlamenti i RMV-së për vitin 2019.....	62
5.1.8 Aktivitete të tjera ndërkombëtare për vitin 2019.....	64
5.1.9 Aktivitetet multilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2020.....	65
5.1.10 Aktivitetet bilaterale të Parlamentit të RMV-së për vitin 2020.....	72
5.1.11 Aktivitete ndërkombëtare BE- Parlamenti i RMV-së për vitin 2020.....	74
5.1.12 Aktivitete të tjera ndërkombëtare për vitin 2020.....	75
KAPITULLI VI: SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI I REALIZUAR...	77
6.1 Intervistat.....	77
PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET.....	94
BIBLIOGRAFIA.....	96

ABSTRAKT

Ky punim ka si objektiv kryesor, të shqyrtojë rolin e Parlamentit në Diplomaci. Në të trajtohet dimensionin i politikës së jashtme dhe i diplomacisë së Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Parlamenti si institucion, krijon delegacione, grupe miqësie dhe këshilla e trupa të tjerë punues, që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe diplomacinë. Ky punim, shqyrton punën dhe kapacitetet “diplomatike” të këtyre delegacioneve, këshillave, grupeve për bashkëpunim dhe trupave punues të Parlamentit.

Në këtë punim janë përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit shkencor, duke nisur nga metodat e përgjithshme të kërkimit shkencor e deri te metodat e veçanta. Nëpërmjet intervistave të realizuara me deputetë që janë anëtarë në delegacione të ndryshme dhe me të punësuar në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Parlamentit të RMV-së, kemi edhe pasqyrim më të plotë të rolit të tyre dhe të parlamentit të RMV-së në Diplomaci. Punimi ka 3 skema, 36 tabela, 13 grafikone dhe 1 diagram, përmes të cilave pasqyrohen aktivitetet diplomatike të delegacioneve të Parlamentit të RMV-së dhe grupeve për bashkëpunim me Parlamentet e vendeve të tjera të botës.

-HYRJE-

Diplomacia, ose thënë më qartë, forma të komunikimit diplomatik, nuk është një dukuri që doli në pah vetëm për shkak të nevojave të shteteve të ndryshme në kohët moderne. Atë e ndeshim që në fillet e historisë së hershme, që nga Asiria (shek. XV-XIV p.e.s, korrespondenca e Tel-Amaranit), Greqia Antike, Perandoria Romake, Bizantine etj. Vazhdon me të njejtin dimension edhe përgjatë Mesjetës, në kohën kur qytet-shtetet “italiane”, në fillim Gjenova e më pas edhe Venediku, u bënë paraprirëset e fazës së diplomacisë paramoderne. Ishte pikërisht kjo periudha kur filluan të njiheshin edhe misionet e para të përherëshme diplomatike. Bashkërisht me format e organizimeve shtetërore, të cilat sigurisht që kanë pasur një evolucion të jashtëzakonshëm përgjatë historisë, edhe diplomacia kishte evoluimin e saj. Në fillim, format e diplomacisë ishin klasike e lehtësisht të njohshme, por sot, krahas diplomacisë klasike apo zyrtare, janë zhvilluar edhe shumë forma të tjera. Diplomacia siç ne e njohim sot, nisi nga ajo që njihet si pika e kthesës në historinë europiane, “Paqja e Vestfalisë” (1648) dhe nga Kongresi i Vienës (1815). Në vitet në vijim, sigurisht që ky lloj i diplomacisë u zhvillua duke u përsosur, e një gjë e tillë më së shumti u vu re ndërmjet shek XVII-XX. Me paraqitjen e së drejtës ndërkombëtare, edhe diplomacia u institucionalizua.

Në shekullin e XX, në periudhën kur zhvillimi industrial kishte marrë ritme të shpejta, në një kohë kur nga ana tjetër, bota përballej me dëmet shkatërruese të shkaktuara nga dy luftërat botërore, që njëkohësisht morrën edhe jetën e miliona njerëzve, u bë e patjetërsueshme nevoja që diplomacia të dilte nga kornizat e njohura deri atëherë, e të zhvillohej në më shumë drejtime. Sidomos pas periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, një periudhë historike kjo në të cilën zhvillimi i teknologjisë mori një tjetër dimension, filloi edhe funksionimi i organizatave të shumta me karakter ndërkombëtar universal ose rajonal, globalizimi u bë kryefjala e kohës, e ky ndryshim botëror, kërkonte një diplomaci të një tjetër niveli e të më shumë dimensioneve.

Kjo pikë kthese historike, na sjell në ditët e sotme kur, përveç diplomacisë tradicionale, kemi edhe lloje të tjera të saj. Kemi diplomaci moderne, diplomaci publike, diplomaci sociale, diplomaci bilaterale dhe multilaterale, diplomaci ekonomike, diplomaci preventive, diplomaci e samiteve, diplomaci ushtarake, diplomaci kulturore, diplomaci të sportit, diplomaci digjitale

(tweet diplomacy apo ONLINE diplomacy) etj dhe sigurisht, diplomacinë parlamentare, që e trajtojmë si temë të këtij punimi.

Në kohën kur marrëdhëniet ndërkombëtare po globalizohen gjithnjë e më tepër, problemet që i tangojnë shtetet, shpeshhere i tejkalojnë kufijtë e vetë shteteve dhe për zgjidhjen e të njejtave domosdoshmërisht që nevojitet bashkëpunim më intenziv në rang ndërkombëtar, qoftë rajonal ose botëror. Në këtë situatë më se e natyrshme është edhe implikimi i parlamentit në diplomaci. Në rastin tonë konkret, duke pasur parasysh se RMV është një vend i vogël me probleme të shumta, si në rrafshin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm, duke pasur parasysh edhe kapacitetet e limituara diplomatike të vendit, kyçja e Parlamentit të RMV-së në diplomaci paraqet mundësi për promovim të vendit në rang ndërkombëtar dhe njëkohësisht krijimin e aleatëve të shumtë, falë bashkëpunimit me të cilët, në nivele të ndryshme, qofshin ato multilaterale ose bilaterale, të mund të ndihmohet në kapërcimin dhe zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat RMV ballafaqohet.

Që të arrihet kjo, nevojitet rol më aktiv i parlamentit në aktivitetet diplomatike, përforsim i kapaciteteve diplomatike, qoftë të shërbimeve profesionale të parlamentit apo të delegacioneve që e prezantojnë atë në forume të ndryshme ndërparlamentare, ose të grupeve për bashkëpunim me parlamentet e shteteve tjera.

Diplomacia parlamentare, në qendër të vëmendjes ka deputetin. Diplomacia parlamentare, promovon bashkëpunimin, mirëbesimin, multikulturalizmin dhe dialogun për çështje të ndryshme.

RMV mund të përfitojë, madje të nxjerrë leksione të shumta nga diplomacia parlamentare. Një shembull konkret të leksionit nga diplomacia parlamentare, se si duhet të funksionojë një shtet me një shoqëri multietnike, na e ka dhënë ish-Spikeri i Senatit të Kanadasë (2006-2014), z. Noel Kinsella. Ai, gjatë një vizite zyrtare që bëri në RMV, më 4 shtator 2013, përpara deputetëve të parlamentit të RMV-së në Shkup, mbajti një fjalim që u shëndrua një leksion diplomacie për shtetet me shoqëri multietnike. Leksioni ishte fare i thjeshtë. Përtej fjalimit të tij, që në raste të tilla është më shumë ceremonial, ky mësim kishte të bëjë me mënyrën se si ai vendosi të përcillte mesazhin e tij për deputetët. Fjalimin e filloi në gjuhën angleze dhe pjesën tjetër e përfundoi në gjuhën frenge. Një veprim kaq i thjeshtë në dukje nga një njeri që i njeh mirë të dyja gjuhët,

përcolli mesazhin e qartë dhe njëkohësisht edhe leksionin më të çmuar për deputetët që duan ta mësojnë të njëjtin, se si duhet të respektohen qytetarët e vendit që përfaqëson. Por si zakonisht në RMV, nga ky leksion, politikanët e shurdhër shumë pak ose aspak nuk nxorrën mësim. Megjithatë, ky rast duhet të shërbejë si shembull që duhet ta ndjekim dhe të shihet si një ndër benefitet e çmuara të diplomacisë parlamentare.

KAPITULLI -I-

1.DIPLOMACIA PARLAMENTARE- ASPEKTET TEORIKE DHE SHFRYTËZIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Diplomacia ka të bëjë me komunikimin, negociimin dhe ndërmjetësimimin formal midis shteteve. Është instrument, përmes të cilit zbatohet politika e jashtme e një shteti. Diplomacia lidhet me vetë shtetin dhe daton që nga paraqitja e vetë shtetit. Vetë fjala **“Diplomaci”**, vjen nga fjala greke **“diploun”**, që në përkthim do të thotë “palosje” apo dokument dyfish i lakuar, e që në kuptimin konceptual, nënkuptonte ndërmjetësim dhe komunikim formal midis shteteve.¹

Diplomacia Parlamentare, si term, fillon të përdoret pas Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia në një farë mënyre sigurisht që ka qenë gjithnjë pjesë e parlamenteve, por vetëm në pjesën ku miratoheshin rezoluta, deklarata, traktate, konventa, apo në pjesën ku ndiqet puna, zgjidhen apo shkarkohen ministrat e jashtëm, kur votohet ose rrëzohet qeveria bashkë me miratimin e programeve të saj, në atë pjesë ku përfshihet edhe politika e jashtme . Diplomacia Parlamentare, ndër të tjera, është obligim i çdo deputeti. Deputetët në çdo situatë, duhet patjetër të nxisin dhe të inkurajojnë diplomacinë parlamentare.²

Pas Luftës së Dytë Botërore, e në veçanti pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, Parlamenti edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, është kthyer në një aktor të rëndësishëm në diplomacinë dhe në politikën e jashtme të një shteti. Në zhvillimin e Diplomacisë Parlamentare, sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë , ka ndikuar kryesisht intensifikimi i bashkëpunimit parlamentar në aspektet e shumta të politikës së jashtme.

Aktualisht, pothuajse secili shtet e ka kthyer diplomacinë parlamentare, në një instrument jashtëzakonisht të rëndësishëm të politikës së tij të jashtme. Në një korrelacion të pandarë, diplomacia tradicionale bashkë me diplomacinë parlamentare, bashkërendisin aktivitetet dhe kontributin e tyre në përfaqësimin sa më dinjitoz të vendit e sidomos për të rritur ndikimin në rrafshin ndërkombëtar.

¹ B.Reka, B.Bashota, Y.Sela, *Marrdhëniet Ndërkombëtare, Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare*, Shkup, 2016, fq.229

² <https://www.sobranie.mk/sessiondetails.nspx?sessionDetailsId=7bccdc8c-4d52-4572-8ffa-c74c1e29b9d1&isNew=undefined>, vizituar më 12, qershor, 2021 – “Stenogrami i Seancës së Parlamentit të RM-së”, mbajtur më 4, shtator, 2013

Deputetët e grupeve parlamentare, të cilët marrin pjesë në forume dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare, mund të kontribuojnë aktivisht duke përfaqësuar në rrafshin ndërkombëtar interesat e shtetit.

Forumet shumëpalëshe parlamentare janë mundësia më ideale për realizimin e diplomacisë parlamentare. Në nivel botëror, një forum i tillë është Unioni Interparlamentar që u krijua në vitin 1889, por edhe forumet e shumta parlamentare të tilla si: Parlamenti Europian, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, e Këshillit të Europës, NATO-s etj.

Diplomacia parlamentare zhvillohet edhe në forumet dypalëshe, në kuadrin e marrëveshjeve parlamentare, grupeve dypalëshe parlamentare të miqësisë, shkëmbimit të vizitave dypalëshe, takimeve të komisioneve të politikës së jashtme dhe seancave plenare, e deri në pjesëmarrjen e deputeteve të ndryshëm në delegacione të nivelit të lartë shtetëror, diplomatik dhe qeveritar. Me kryetarët e tyre, organizohen forume të posaçme ndërparlamentare³.

Diplomacia parlamentare luan rol të jashtëzakonshëm në krijimin e urave të bashkëpunimit e miqësisë mes vendeve të ndryshme, qoftë në aspektin bilateral, apo në atë multilateral.

Diplomacia parlamentare është më se e nevojshme për shtetet e vogla, shtetet që janë në zhvillim dhe që duan një vend të respektuar në arenën ndërkombëtare. Këto shtete, nëpërmjet diplomacisë parlamentare, kanë gjasa të mëdha të arrijnë rezultate në aspektin e promovimit të vendit në arenën ndërkombëtare.

³ <http://shtetiweb.org/2014/08/22/risi-ne-diplomacine-parlamentare/> Jorgji Kote, “Risi në diplomacinë parlamentare”, botuar në Balkanweb, 22, gusht, 2014, vizituar më 12, qershor, 2021.

1.1. NOCIONI DHE HISTORIKU I DIPLOMACISË PARLAMENTARE

Forma të diplomacisë parlamentare, i gjejmë që në kohët e lashta. Nëse thuhet se diplomatët përfaqësojnë sovranin e tyre⁴, atëherë deputetët, si përfaqësues të “sovranit”, domosdoshmërisht duhet të luajnë rol të rëndësishëm edhe në diplomaci. Janë të njohura historikisht aktivitetet e shumta diplomatike të senatorëve romakë, të cilët, falë shkathtësive të tyre diplomatike në komunikim dhe negociim, luajtën një rol të rëndësishëm në krijimin e Perandorisë Romake, perandorisë më të fuqishme të kohës së saj, gjurmët dhe hija e së cilës shfaqen edhe sot. Këta senatorë-diplomatë, jo vetëm që ndihmuan ekspansionin e Perandorisë Romake, por shpeshherë, edhe në kohët më të vështira të saj, pikërisht falë diplomacisë, parandaluan shkatërrimin e perandorisë nga sulmet e ndryshme dhe në këtë mënyrë, zgjatën edhe për disa shekuj jetëgjatësinë e saj.

Edhe në periudha të tjera të historisë, hasim aktivitete diplomatike të parlamentarëve, ndonëse periudha që pasoi ishte periudhë më së shumti një periudhë e “diplomacisë së brendshme”, ku kapacitetet diplomatike ishin të orientuara në kufizimet e pushtetit absolutist që kishin monarkët e kohës.

Diplomacia Parlamentare, si term, filloi të paraqitet pas Luftës së Dytë Botërore. Nëse shkojmë pas, në vitin 1950, në kohën kur kjo frazë u përdor për herë të parë, diplomacia parlamentare, i referohej përdorimit të procedurave parlamentare në negociata ndërqeveritare, për të lehtësuar funksionimin e diplomacisë klasike.⁵ Pas Luftës së Ftohtë, diplomacia parlamentare u zhvillua më shumë falë bashkëpunimit intenziv të parlamenteve, mes vendeve të ish bllokut komunist me SHBA-në dhe vendet e BE-së. Ky bashkëpunim kishte për qëllim t’i ndihmonte ish vendet komuniste, që të kalojnë sa më lehtë tranzicionin politik, nga sistemi komunist në atë demokratik. Kështu, falë këtij bashkëpunimi, diplomacia parlamentare fillon dhe zhvillohet. Për ta definuar diplomacinë parlamentare, na ndihmon kategorizimi i aktiviteteteve që na e ofron Unioni Interparlamentar. Diplomacia Parlamentare ngërthen në vetvete një numër të madh aktivitetesh, përfshirë këtu: përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërparlamentar, për të promovuar marrdhëniet ndër-shtetërore; organizimin e takimeve dhe vizitave të

⁴ Charles Chatterjee, *International law and diplomacy*, Routledge, London, 2010, fq.8

⁵ Stelios Stavridis, Davor Jançiç, *Parliamentary Diplomacy in European and Global Governance*, E.J Brill, Leiden, 2017, fq.5

institucionalizuara dhe të rregullta midis parlamentarëve, por gjithashtu edhe anëtarëve të komisioneve, takime këto që synojnë zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë; dhe pjesëmarrja në organet dhe konferencat ndërparlamentare shumëpalëshe.⁶ Bazuar në këtë D. Jançiçi, Diplomacinë Parlamentare në kuptimin më të gjërë, e definon si veprim individual ose kolektiv, nga parlamentarë që synojnë të katalizojnë, lehtësojnë dhe forcojnë funksionet ekzistuese kushtetuese të parlamenteve, përmes dialogimit mes kolegëve, për çështje të panumërta të hapura politike në të gjitha kontinentet dhe nivelet e qeverisjes.⁷

1.2. IMPAKTI I DIPLOMACISË PARLAMENTARE NË MARRDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Diplomacia parlamentare, gjithsesi ndikon në shumë drejtime në marrdhëniet ndërkombëtare. Roli i Parlamentit në marrdhëniet ndërkombëtare është determinues, sepse në fund, shumica e marrëveshjeve me karakter ndërkombëtar, duhet të “vulosën” nga ana e parlamenteve përmes të miratimit të tyre. Kemi plot shembuj ku parlamenti luan rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një ndër to, është edhe ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës nga ana e parlamenteve të RMV-së dhe R. së Greqisë, marrëveshje kjo, që ndonëse në dukje ishte vetëm zgjidhje e problemit në mes dy shteteve fqinje, në thelb, me efektet e saj, i tejkalon kufijtë e këtyre dy shteteve. Impakt të njëjtë ka edhe Marrëveshja e Ohrit, e cila, ndonëse ishte një Marrëveshje që ndaloi konfliktin ushtarak brenda në vend, involvoi shumë fuqishëm diplomacinë amerikane dhe atë europiane, duke i kthyer të dy këto palë, në faktorin kryesor të arritjes së Marrëveshjes, e në fund, mes shumë polemikash, edhe Parlamenti i RMV-së ndryshoi Kushtetutën duke inkorporuar në të Marrëveshjen e Ohrit. Impakti i diplomacisë parlamentare në marrëdhëniet ndërkombëtare, në shumë raste ka të bëjë me ndërmjetësimin apo hapjen e ndonjë shtegu të ri për t’i deblokuar pengesat e paraqitura drejt zgjidhjes së problemeve apo për t’i lëvizur proceset përpara. Në këtë drejtim, shquhen me iniciativa të tilla SHBA-të, nëpërmjet përfaqësuesve të Kongresit dhe deputetët e Parlamentit European. Shembull i rolit aktiv të

⁶ <http://archive.ipu.org/splz-e/sp-conf05/involvement-rpt.pdf>, vizituar më 8, Qershor, 2021.- IPU, ‘Parliamentary Involvement in International Affairs’, Raporti i Konferencës së dytë Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve” (New York, 7-9 Shtator 2005), fq. 8.

⁷ Stelios Stavridis, Davor Jançiç, *Parliamentary Diplomacy in European and Global Governance*, E.J Brill, Leiden, 2017, fq.6

diplomacisë parlamentare, është edhe ndërmjetësimi i tre Euro-deputetëve, Riçard Hovit, Ivo Vajgëll dhe Eduard Kukan, në arritjen e Marrëveshjes së Përzahinos në RMV.

Në RMV, Parlamenti, sipas Kushtetutës, është organi që ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare⁸. Ato mund të jenë në formë marrëveshjeje, rezolute, deklarate, karta të ndryshme etj. Parlamenti i RMV-së, që nga mëvetësimi i shtetit, ka ratifikuar një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare, qofshin ato si pasojë e bashkëpunimit bilateral ose multilateral, apo si pasojë e anëtarësimit të RMV-së në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Gjithashtu, parlamenti, ka të drejtë të miratojë deklarata, rezoluta dhe vendime të tjera.

Marrëdhëniet ndërkombëtare në realitetin bashkëkohor, paraqesin një ambient të tregut botëror⁹, prandaj parlamenti duhet të adaptohet ndaj këtij realiteti dhe të aftësohet sa më shumë që të dijë se si të gjendet në këtë realitet të ri dhe si të ballafaqohet me sfidat që ky realitet sjell. Parlamenti i RMV-së luan edhe një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, e që ka të bëjë me përpjekjet e RMV-së për integrimin e saj në BE. Në këtë drejtim, parlamenti i RMV-së, përveç se ka krijuar komisione dhe trupa të veçantë për këtë qëllim, si organ i tërë zbaton edhe kriterin legjislativ (“acquis”) të BE-së, duke miratuar (njehsuar) ligjet e RMV-së me ato të BE-së. Parlamenti i RMV-së bashkëpunon dhe merr pjesë si vend kandidat për në BE, edhe në takime të ndryshme, qoftë të shërbimeve profesionale të Kuvendit, ose në takime në nivel të deputetëve, siç është programi i Parlamentit Europian për mbështetje të parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Parlamenti i RMV-së merr pjesë në shumë nisma tjera të karakterit rajonal, që kanë për qëllim të nxisin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave të mira ndërmjet parlamenteve të rajonit, siç është Iniciativa e Jon-Adriatikut dhe forume të tjera të ndryshme me karakter ndërkombëtar.

Parlamenti i RMV-së, për bashkëpunim ndërkombëtar formon delegacione, grupe parlamentare për bashkëpunim, këshilla dhe trupa punues¹⁰.

⁸ Kushtetuta e RMV-së, neni 68

⁹ Jonuz Abdullahi, *Politika dhe politikat publike*, Botimi i tretë, Arbëria Design, Tetovë, 2016, fq.158

¹⁰ Rregullorja e punës së Parlamentit të RMV-së, neni 108

KAPITULLI –II-

2.PARLAMENTI I RMV-SË –ROLI I TIJ NË “DIPLOMACINË E INFLUENCËS”

Republika e Maqedonisë së Veriut, si një shtet relativisht i ri, nuk shquhet shumë në diplomaci në arenën ndërkombëtare. Kjo, falë ndikimit të shumë faktorëve, duke filluar nga mospasja e traditës në diplomaci, problemet që i ka pasur dhe që ende i ka me disa nga fqinjët e saj dhe nga problemet e brendshme, që asesi të zgjidhen, e që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike, në veçanti me shqiptarët, që ende nuk po arrijnë t'i fitojnë të drejtat e tyre dhe statusin e merituar në shtet, por edhe për shkak të problemeve të tjera të shumta, që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, sundimin e së drejtës, krimin e organizuar, korupsionin etj.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si një shtet i ri dhe i vogël, e ka shumë të vështirë të depërtojë në arenën ndërkombëtare me diplomacinë tradicionale apo klasike. Për shtetet si RMV, ndihma e diplomacisë parlamentare në krijimin e miqve në arenën ndërkombëtare, është jetike.

Diplomacia Parlamentare bëhet më se e nevojshme në relacionet e reja ndërkombëtare, ku bashkëpunimi intenziv në “klubet” rajonale të shteteve, i tejkalon kufijtë dhe sovranitetet e shteteve në disa fusha, siç është shembulli me Bashkimin European. Shtetet e vogla, në këtë realitet të ri të bashkëpunimit intenziv me karakter ndërkombëtar apo rajonal, ku krijohen aleanca të ndryshme politike, diplomatike por edhe ushtarake, e kanë të domosdoshme të fuqizojnë diplomacinë. Diplomacia është aftësi, gjegjësisht talent abstrakt¹¹. Parlamentet duhet të aftësohen sa më shumë në diplomaci, sepse, nëpërmjet aktiviteteve diplomatike, mund të zgjidhin probleme të shumta dhe në këto rrethana të bashkëpunimit intenziv ndërmjet shteteve dhe ndërmjet parlamenteve, diplomacia parlamentare mund të ndihmon shumë edhe diplomacinë tradicionale. Parlamenti i RMV-së, me delegacionet e tij në asamblëtë e ndryshme parlamentare, nëpërmjet bashkëpunimit multilateral, mund të ndikojë dhe të përfitojë shumë në ngjarjet rajonale dhe të zë vend të respektuar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përveç bashkëpunimit rajonal, Parlamenti i RMV-së nëpërmjet grupeve për bashkëpunim me Parlamentet e vendeve të tjera, mund të zë miq të fuqishëm në arenën ndërkombëtare. Po, por t'i arritur këto objektiva, Parlamenti i RMV-së duhet të jetë më aktiv në diplomacinë parlamentare, sepse sot, me ndihmën


¹¹ Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq.247

e bashkëpunimit multilateral dhe bilateral, mund të zgjidhen edhe shumë probleme të brendshme. Andaj, është më se e nevojshme që Parlamenti i RMV-së përveç fokusimit në problemet e brendshme, fokus ky që lë shumë për të dëshiruar, duhet të fokusohet dhe të marrë rol më aktiv edhe në diplomacinë parlamentare.

2.1 DIPLOMACIA PARLAMENTARE, SFIDË PËR PARLAMENTIN E RMV-SË

Përveç funksioneve legislative dhe mbykëqyrëse, Parlamenti luan rol të rëndësishëm edhe në diplomaci. Për RMV-në, diplomacia parlamentare paraqet sfida të vërtetë. Në aspektin formal, diplomacia parlamentare është mirë e organizuar, por vërehet se mungojnë aktivitetet, ose, edhe nëse ka aktivitete, ato janë më shumë të karakterit “protokollar”. Nëse do të përdornim një skemë si do të dukej organizimi i diplomacisë parlamentare në RMV, ai të dukej kështu:

SKEMA NR.1



Nga kjo skemë, mund të shohim se mundësitë për zhvillimin e diplomacisë së suksesshme nga ana e parlamentit, janë shumë të mëdha. Diplomacia Parlamentare përfshin në vete të gjithë spektrin e shoqërisë së vendit, spektrin politik, marrëdhëniet pozitive-opozitive, spektrin etnik,

shqiptarë-maqedonas-të tjerë, si dhe gjitha aspektet e tjera të shtetit, gjë kjo që paraqet një përparësi të madhe për një vend siç është RMV.

Kryetari i Parlamentit, përveç që udhëheq me seancat parlamentare si spiker, ai përfaqëson parlamentin edhe në arenën ndërkombëtare. Roli “diplomatik” i Kryetarit të Parlamentit, ndihmon shumë, në rradhë të parë në udhëheqjen me institucionin brenda në vend dhe më pas, edhe në promovimin e vendit në arenën ndërkombëtare. Takimet “diplomatike” të Kryetarit të Kuvendit janë të shpeshta, duke filluar që nga takimet me përfaqësuesit e huaj diplomatikë që janë të akredituar në vendin tone, pritje të delegacioneve të huaja që vijnë për vizita zyrtare në RMV, vizitat zyrtare të Kryetarit të Parlamentit jashtë vendit, e deri te pjesëmarrja nëpër konferenca, samite dhe sesione të ndryshme me karakter ndërkombëtar.

Edhe deputetët, si individë, kanë mundësi të mëdha për angazhim në diplomacinë parlamentare, por fatkeqsisht, në RMV janë shumë të rrallë deputetët që shquhen për iniciativa dhe aktivitete diplomatike. Një pjesë shumë e madhe e tyre, nuk arrijnë dalin nga rrethi që ua “vizaton” partia. Madje ka shumë të tillë që nuk shprehin fare interes në rradhë të parë për çështjet dhe detyrat e tyre të përditshme brenda parlamentit, e të mos flasim për interesim për aktivitetet diplomatike. Aktiviteti më i madh “diplomatik” i deputetëve të tillë, është eventualisht ndonjë takim i realizuar me përfaqësues të niveleve të ulëta të përfaqësive diplomatike në vend.

Kur vjen puna tek aktivitetet diplomatike të partive politike të përfaqësuara në Kuvend, secila parti, “aktiviteteve diplomatike” të saj, i përdor më shumë për të arritur objektivat dhe qëllimet partiake, se sa të përfaqësojnë interesat e qytetarëve në përgjithësi. Aktiviteti i partive politike, më së shumti përqëndrohet në bashkëpunimin me familjet e tyre politike evropiane dhe partitë simotra. Partitë maqedonase, për dallim nga partitë shqiptare, janë pjesë e familjeve të partive evropiane, VMRO-DPMNE është anëtare e asociuar e Partive Popullore Evropiane, parti të qendrës së djathtë (EPP-European People’s Party), LSDM, është anëtare e asociuar e partive të majta (PES The Party of European Socialists). Sa i përket partive shqiptare, ato ngecin në këtë drejtim, asnjëra parti shqiptare nga RMV deri më tani, nuk është anëtare e ndonjë familje të madhe të partive evropiane. Shpeshherë e kemi parë përkrahjen e drejpërdrejtë të partive simotra evropiane dhënë partive maqedonase në RMV. Po përveç kësaj përkrahjeje, as partitë maqedonase nuk shquhen për ndonjë aktivitet tjetër diplomatik. Aktivitetet diplomatike të partive shqiptare të përfaqësuara në parlament, qoftë të BDI-së, PDSH-së, Aleancë&Alternativë-s apo

Besës, më së shumti përkufizohen me takime “protokollare”, atëherë kur RMV-në e vizitojnë delegacione apo diplomatë të ndryshëm nga vendet e BE-së dhe nga SHBA-ja, ose në takime me përfaqësues diplomatikë të vendeve të huaja të akredituara në RMV.

Meqë punën e trupave punuese (komisionet) të Parlamentit, delegacioneve dhe grupeve për bashkëpunim, do t'i analizojmë në kapituj të veçantë, këtu vlen të përmendim se, komisionet parlamentare të cilat më së shumti mund të merren me “aktivitete diplomatike” janë: Komisioni për Politikë të Jashtme; Komisioni për Çështje Europiane dhe Këshilli Nacional për Euro-integrime. Për bashkëpunim multilateral, parlamenti i RMV-së zakonisht formon 9 delegacione që marrin pjesë në Asamble të ndryshme parlamentare me karakter ndërkombëtar, botëror ose rajonal. Përbërja e re parlamentare 2020-2024, për këtë qëllim ka formuar 10 delegacione të tilla. Për bashkëpunim bilateral, parlamenti i RMV-së formon grupe për bashkëpunim. Parlamenti i RMV-së formon 50 grupe për bashkëpunim me parlamentet e ndryshme të botës.

Për ta realizuar me sukses këtë sfidë, është shumë e rëndësishme cilësia dhe pregaditja e deputetëve. Cilësia dhe pregaditja “diplomatike” e deputetëve, vërehet se mungon, edhe pse mundësitë formale për aktivitete diplomatike janë të shumta dhe deri diku mirë të organizuara.

2.2 RAPORTET MES DIPLOMACISË PARLAMENTARE DHE ASAJ TRADICIONALE-“ZYRTARE”

Diplomacinë zyrtare e përfaqëson Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ). Ministria e Punëve të Jashtme, përfaqëson dhe koordinon aktivitetet zyrtare në marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit. MPJ udhëheq me diplomacinë zyrtare, me përfaqësitë diplomatike-konzullore të RMV-së nëpër botë, si dhe merret me aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të vendit dhe me diplomacinë. RMV, si shtet i vogël, nuk mund t'i përballoj kostot që të ketë përfaqësi diplomatike-konzullore në shumë vende të botës. Për këtë shkak, RMV me kujdes duhet të zgjedhë se në cilat vende duhet të hapë përfaqësi diplomatike-konzullore, zakonisht kjo përzgjedhje duhet të niset nga kritere që kanë të bëjnë me realizimin e interesave të RMV-së qofshin ato politike, ekonomike etj.

RMV nëpër botë ka hapur 43 ambasada. Prej tyre numri më i madh i ambasadave është në Evropë, 31 (Shqipëri, Kosovë, Austri, Belgjikë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Vatikan, Britani e Madhe, Gjermani, Greqi, Danimarkë, Estoni, Itali, Norvegji, Poloni, Rumani, Rusi, Slloveni, Sërbi, Turqi, Ukrainë, Hungari, Francë, Holandë, Kroaci, Mali i Zi, Çeki, Zvicër, Suedi ,Spanjë dhe nga qershori 2021 edhe në Sllovaki) dhe në pjesën tjetër të botës, 2 në Amerikën Veriore (SHBA dhe Kanada), 1 në Amerikën Jugore (Brazil), 1 në Australi , 1 në Afrikë (Egjipt) dhe 7 në Azi (Izrael, Indi, Japoni, Kazakistan, Katar, Kinë dhe në Emiratet e Bashkuara Arabe). RMV, përveç ambasadave, ka edhe përfaqësi konzullore edhe atë; 5 në Evropë (Gjermani 2, Itali 1, Turqi 1, Greqi 1), kurse në kontinentet tjera, RMV ka përfaqësi konzullore në SHBA 3, Kanada 1 dhe Australi 3. RMV përfaqësohet edhe me misione të përhershme në organizatat ndërkombëtare. Misione të përhershme në këto organizata, RMV ka në OSBE, NATO, OKB në New Jork dhe Gjenevë, FAO, Unionin European, Këshillin e Evropës dhe Unesco.¹²

SKEMA NR.2¹³

PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË RMV-SË NËPËR BOTË

1.Ambasada -43

- Europë -31
- Amerikën eVeriut -2
- Amerikën e Jugut- 1
- Azi -7
- Australi -1
- Afrikë-1

2.Përfaqësitë Konzullore- 12

- Europë- 5
- Amerikën e Veriut - 4
- Australi- 3

3. Misionet e Përhershme në Organizata Ndërkombëtare- 8

PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE- KONZULLORE TË HUAJA TË AKREDITUARA NË RMV

1.Ambasada-31

2. Përfaqësi Konzullore-44

3. Organizata të tjera ndërkombëtare-mbi 30

¹² <https://mfa.gov.mk/mk/page/37/europe/ambasadi>, vizituar më 10. 06. 2021

¹³ <https://www.mfa.gov.mk/mk/>, vizituar më 10.06.2021

Sa i përket përfaqësive diplomatike-konzullore të huaja që janë të akredituara në vendin tonë, në RMV kemi 31 ambasada të akredituara të shteteve të huaja, 44 përfaqësi konzullore (disa shtete kanë të hapura vetëm përfaqësi konzullore në Shkup, por jo edhe ambasada, kurse disa shtete të tjera kanë të hapura edhe ambasadë në Shkup, edhe përfaqësi konzullore në ndonjë qytet siç janë: Manastiri, Ohri, Shtipi, Struga, Dibra dhe Strumica. Disa shtete kanë të hapura ambasadë dhe nga dy përfaqësi konzullore ,siç është rasti i R.së Kosovës, që ka përfaqësi konzullore në Strugë dhe Dibër, R. e Turqisë ka përfaqësi konzullore në Manastir dhe Strugë , R. e Rumanisë dhe R. e Malit Zi, që ka përfaqësi konzullore në Manastir dhe Shtip dhe Federata Ruse dhe R. e Hungarisë, që kanë përfaqësi konzullore në Manastir dhe Ohër. Në RMV gjithashtu me përfaqësitë e tyre janë edhe mbi 30 organizata, institucione dhe misione ndërkombëtare. Vlen të potencohet se, që nga pavarësia, kemi edhe dy raste të mbylljeve të ambasadave të vendeve të huaja në vendin tonë. Është rasti i mbylljes së ambasadës së Norvegjisë më vitin 2012 dhe ambasadës së Republikës Islamike të Iranit, në vitin 2020. Gjithashtu, së shpejti priten që të hapen edhe dy ambasada të reja, ambasada e Izraelit dhe e Brazilit. Vendet që nuk kanë të hapura ambasada ose përfaqësi konzullore, marrëdhëniet diplomatike me RMV-në i mbajnë nëpërmjet ambasadorëve jo-rezident, që zakonisht janë të vendosura me përfaqësitë e tyre nëpër vendet fqinje ose vendet e tjera të rajonit.

Nga kjo, mund të konstatojmë se Maqedonia formalisht qëndron mirë me përfaqësitë diplomatike-konzullore në vendet dhe organizatat ndërkombëtare më kryesore. Ajo që vërehet, në veçanti me përfaqësitë konzullore, është se këto përfaqësi janë hapur më së shumti vetëm në vendet ku supozohet se ka diasporë maqedonase, kurse në vendet ku ka diasporë shqiptare, psh në Zvicër dhe vende të tjera, nuk kemi përfaqësi konzullore të RMV-së. Përveç kësaj, shumë ambasada nuk kanë ende ambasadorë të emëruar, një pjesë e madhe funksionon me personel të paktë, gjë që ndikon që punët të mos kryhen në nivelin e duhur. Disa here opinioni ka qenë dëshmitar edhe i disa skandaleve që kanë ndodhur nëpër përfaqësitë diplomatike nga “diplomatët” e RMV-së. Krejt kjo është si pasojë e politizimit të skajshëm të shërbimit diplomatik, ku profesionalizmi ekziston vetëm formalisht nëpër ligje e dokumente, por shumë rrallë respektohet. Edhe aty ku emërimet duhet të jenë profesionale, e që si rregull ligjor duhet që 80% e përfaqësuesve diplomatikë të jenë profesionistë, në praktikë kjo nënkuptohet si “profesionisti i partisë”, që realisht gjithçka mund të jetë, vetëm jo diplomat profesionist.

Parlamenti i RMV-së, më saktë Komisioni për Politikë të Jashtme , bashkë me Qeverinë, më saktë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me Presidentin, luajnë rolin kryesor në emërimin e ambasadorëve të vendit në përfaqësitë diplomatike të RMV-së, sepse sistemi diplomatik tani përfshin shumë më tepër sesa thjesht punën e misioneve rezidente.¹⁴


Roli i Parlamentit të RMV-së në këtë drejtim, ka të bëjë me dëgjimin, referimin dhe prezentimin e planit për aktivitetet diplomatike të kandidatëve për Ambasadorë para Komisionit për Punë të Jashtme. Komisioni, në fund zakonisht duhet të jepë “dritë të gjelbërt”, pra pëlqim dhe të njoftojë për vendimin Ministrinë e Punëve të Jashtme, që më pas ky institucion të vazhdojë me procedurën e emërimit të ambasadorëve. Edhe në seancat e Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit të RMV-së, vërehet se shumica parlamentare i pranon dhe i përkrah vendimet për emërimin e ambasadorëve pa ndonjë debat të mirëfilltë. Të vetmit që ndonjëherë me raste reagojnë, janë deputetët e opozitës, por në fund, gjithmonë kundërshtimi i tyre, mbivotohet nga shumica parlamentare.

Parlamenti i RMV-së, për dallim nga MPJ, formon 10 delegacione për bashkëpunime multilaterale dhe 50 grupe për bashkëpunim bilateral me vendet e ndryshme të botës. Kjo tregon se kapacitetet formale të Parlamentit të RMV-së për diplomaci, janë më se të mjaftueshme për t’i ndihmuar diplomacisë zyrtare që udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Parlamenti dhe MPJ duhet të bashkëpunojnë më ngushtë, t’i koordinojnë aktivitetet mes tyre dhe ta plotësojnë njëri tjetrin me aktivitete, që të arrihen rezultate sa më të mira në përfaqësimin e vendit në arenën ndërkombëtare.

Bashkëpunimi më i mirë mes MPJ-së dhe Parlamentit qëndron në bashkëpunimin e shërbimeve profesionale, të administratës së këtyre dy institucioneve. Për çdo aktivitet ndërkombëtar shërbimet profesionale të MPJ-së, i njoftojnë deputetët me informatat e nevojshme, me qëllim që të jenë sa më të përgaditur rreth aktivitetit. Edhe bashkëpunimi i shërbimeve të Parlamentit me administratën e MPJ-së dhe me përfaqësitë diplomatike-konzullore, është në nivel të duhur.

¹⁴ G.R. Berridge, *Diplomacy: Theory and Practice, fifth edition*, Palgrave Macmillan, UK, 2015, fq.25

SKEMA NR.3



2.3 INTEGRIMET RAJONALE DHE DIPLOMACIA PARLAMENTARE

Parlamenti i RMV-së luan edhe një rol të rëndësishëm në integrimet rajonale, e që ka të bëjë me përpjekjet e RMV-së për integrimin e saj në BE. Diplomacia evropiane ishte kalitur në shkollën e situatave të vështira¹⁵. Në këtë drejtim, parlamenti i RMV-së, përveç se ka krijuar komisione dhe trupa të veçantë për këtë qëllim, si organ i tërë zbaton edhe kriterin legjislativ (“acquis”) të BE-së, duke miratuar (njehsuar) ligjet e RMV-së me ato të BE-së. Parlamenti i RMV-së bashkëpunon dhe merr pjesë si vend kandidat për në BE, edhe në takime të ndryshme, qoftë të shërbimeve profesionale të Kuvendit ose në takime në nivel të deputetëve, siç është programi e Parlamentit European për mbështetje të parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Integrimet rajonale, përveç të tjerave, paraqesin edhe proces të socializimit midis vendeve dhe

¹⁵ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999, fq.20

kulturave të ndryshme. Në këtë rast, diplomacia ka të bëjë edhe me socializimin. Procesi i socializimit, mund të zhvillohet midis shteteve që veprojnë në nivelin ndërkombëtar dhe midis përfaqësuesve të tyre.¹⁶

Parlamenti i RMV-së, merr pjesë në shumë nisma të tjera të karakterit rajonal, që kanë për qëllim të nxisin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave të mira ndërmjet parlamenteve të rajonit, siç është Iniciativa e Jon-Adriatikut dhe forume të tjera të ndryshme me karakter ndërkombëtar.

2.4 PËRPARËSITË, MUNDËSITË DHE “ RREZIQET” E DIPLOMACISË PARLAMENTARE

Bashkëpunimi intenziv i vendeve në sfera të ndryshme në nivel ndërkombëtar, zhvillimi i pandalshëm i teknologjisë dhe komunikimit por edhe globalizimi, bën që çështjet kryesore të varen nga bashkëpunimi ndërkombëtar. Parlamenti, si organ legjislativ, mbykëqyrës dhe kontrollues, si organ që përfaqëson qytetarët e një vendi, medoemos duhet të ndjekë edhe trendin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Si pasojë e zhvillimeve të hovshme, vetë diplomacia u zhvillua në shumë lloje të saj, një ndër këto është edhe diplomacia parlamentare. Këtë më së miri e kanë kuptuar vendet më të zhvilluara, siç është SHBA, Kongresi i tyre dhe Parlamenti European, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në diplomaci dhe që kanë tradita për negociim¹⁷. RMV, përgjatë gjithë kësaj periudhe prej nga pavarësia, ka arritur të krijojë një kornizë të mirë për bashkëpunim multilateral dhe bilateral me institucione dhe vende të ndryshme, kjo paraqet edhe mundësi për zhvillimin e diplomacisë parlamentare. Diplomacia parlamentare ka shumë përparësi dhe ofron shumë mundësi. Njëra nga përparsitë kryesore, është spektri gjithëpërfshirës politik dhe etnik, që do të thotë, prezantimi i vlerave demokratike të vendit në arenën ndërkombëtare. Diplomacia Parlamentare paraqet mundësi për pjesëmarrje aktive në arenën ndërkombëtare, mundësi për përforcimin e dialogut ndërparlamentar, për krijimin e miqësive dhe përforcimin e marrëdhënieve me aleatët, si dhe për shkëmbimin e përvojave dhe ideve më të mira. Diplomacia Parlamentare mund të ndihmojë edhe në raste ”krizash”, atëherë kur kanalet diplomatike “zyrtare”, janë të ndërprera. Të jesh aktiv në forumet parlamentare ndërkombëtare,

¹⁶ Clive Archer, *International Organizations-Third Edition*, Routledge, London, 2001, fq. 101

¹⁷ Veton Latifi, *Negocimi si teknikë parësore për zgjidhjen e konflikteve: Zhvillimi i Negociatave 2*, Instituti i Ohrit, Shkup, 2007, fq. 98

sjell benefite të shumta. Këto forume parlamentare, nxisin debatin publik mbi çështjet diplomatike globale dhe synojnë të kenë një ndikim në situata delikate, kur kanalet ndërqeveritare të politikës ndërkombëtare janë shteruar ose nuk mund të përdoren. Në teori pra, njësoj si në praktikë, në themel të parlamentarizmit të çështjeve ndërkombëtare, qëndron tradita demokratike.¹⁸

Diplomacia Parlamentare ka edhe rreziqe. Disa nga rreziqet, kanë të bëjnë me kyçjen e spektrit gjithpërfshirës politik, që mund të rezultojë me qëndrime të ndryshme për çështje të caktuara. Problemet e brendshme shumë lehtë mund të barten në arenën ndërkombëtare. Rrezik tjetër, është edhe ai që disa deputetë, përfaqësues të delegacioneve për bashkëpunim multilateral dhe bilateral, diplomacinë parlamentare ta ngatërrojnë (e kjo ka ndodhur në shumë raste), me “shopping diplomacy”.

Por pavarësisht këtyre rreziqeve, përparësitë dhe mundësitë janë shumë më të mëdha. RMV, si vend i vogël me kapacitete të limituara, nëse do që të ketë vend të respektueshëm në arenën ndërkombëtare, e ka patjetër t’i përdorë të gjitha kapacitetet në këtë drejtim, e ajo që më së shumti që mund t’i ndihmojë diplomacisë tradicionale në këtë drejtim, është pikërisht diplomacia parlamentare.

¹⁸ Stelios Stavridis, Davor Jançiç, *Parliamentary Diplomacy in European and Global Governance*, E.J.Brill, Leiden, 2017, fq 3-4

KAPITULLI –III-

3. ROLI ,KAPACITETET DHE AKTIVITETI DIPLOMATIK I DELEGACIONEVE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË

Për bashkëpunim multilateral, Parlamenti i RMV-së formon delegacione të përhershme në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Delegacionet, në përbërjet e tyre, duhet të sigurojnë përfaqësim të drejtë të partive politike ose grupeve në parlament, përfaqësim të drejtë në baza etnike dhe përfaqësim të drejtë gjinor. Ky parim , ndonjëhere për arsye objektive, ndonjëherë për arsye politike apo arsye të tjera, vështirë implementohet.

Për bashkëpunim multilateral, Parlamenti formon delegacione të përhershme në këto organizata ndërkombëtare: Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (AP KE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë (AP OSBE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (AP NATO), Unionin Interparlamentar (UIP), Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Europës Qendrore (DP IEQ), Asamblenë Parlamentare të Mesdheut (AP e Mesdheut) dhe Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore (AP PBEJL).

Parlamenti formon edhe delegacion të Seksionit të Parlamentit në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë dhe në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim (Komiteti i Përzier Parlamentar RMV-BE).

Parlamenti i RMV-së krijon edhe grupe për bashkëpunim bilateral mes parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës. Këto grupe, ndryshe quhen edhe “Grupe për miqësi”. Në mandatin paraprak 2017-2020, parlamenti, për bashkëpunim bilateral ka formuar gjithsej 46 grupe për bashkëpunim¹⁹, kurse në mandatin aktual 2020-2024 parlamenti i RMV-së, për këtë qëllim, ka formuar 50 grupe për bashkëpunim²⁰. Qëllimi i këtyre grupeve parlamentare për miqësi, është që, nëpërmjet bashkëpunimit bilateral mes vendeve të ndryshme të botës, të krijohet marrëdhënie bashkëpunimi, të shkëmbehen përvoja dhe të krijohen raporte miqësore me vende të ndryshme të botës, me të vetmin qëllim, afirmimin e RMV-së në arenën ndërkombëtare.

¹⁹ www.sobranie.mk -“Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV”-së për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

²⁰ www.sobranie.mk -“Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV”-së për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

3.1 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EUROPËS (AP KE)

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, është asambleja e parë europiane e krijuar në historinë e kontinentit të Europës. Me delegacione nga 46 parlamente kombëtare, ajo është asambleja europiane me bazë më të gjerë. Meqenëse ka një numër të barabartë të përfaqësuesve dhe zëvendësuesve të tyre, numri i përgjithshëm i anëtarëve të Asamblesë është 648, plus 30 vëzhgues dhe 30 Partnerë për Demokracinë²¹. Anëtarët e asamblesë zgjidhen ose emërohen nga parlamentet e vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Çdo vend ka nga 2 deri 18 anëtarë në Asamble, varësisht nga numri i popullatës. Delegacioni i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (AP KE), përbëhet nga 3 anëtarë dhe po aq zëvendës anëtarë, që janë deputetë në Parlament. Delegacioni ka njërin anëtar si shef të delegacionit.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, ka në përbërjen e saj 5 grupe politike: Grupi Socialist (SOC), Grupi i Partive Popullore Europiane (EPP-CD), Grupi Demokratik European (EDG), Grupi Liberal, Demokratik dhe i Reformatorëve (LDR), si dhe Grupin e së Majtës së Bashkuar Europiane (UEL). Megjithë këtë ndarje në dukje të qartë politike, ka anëtarë të Asamblesë së KE-së, të cilët preferojnë të mos jenë pjesë e asnjërit prej këtyre 5 grupeve. Por padyshim që është shumë e rëndësishme të bëhesh pjesë e grupit, politikat e të cilit janë më të përafërta me politikat e anëtarit, sepse vetëm në këtë mënyrë krijohen mundësi më të mëdha për të vënë urat e bashkëpunimit jo vetëm mes këtyre anëtarëve, por edhe mes Parlamenteve të vendeve anëtare të Këshillit të Europës.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, mbledhet katër herë në vit në Strasburg, në një seancë plenare javore që mbahet në Sallën e Pallatit të Europës (Palais de l'Europe). Ajo mban edhe një takim çdo pranverë, në njërin nga shtetet anëtare. Sesionet e AP-KE-së, janë gjithnjë publike.

Kjo Asamble kryesisht debaton rreth ngjarjeve që ndodhin në Europë por padyshim edhe për ngjarjet e rëndësishme botërore. Ajo ka luajtur gjithmonë një rol jashtëzakonisht aktiv në

²¹ <https://pace.coe.int/en/pages/representation>, vizituar më 20.06.2021

menaxhimiin e krizave të ndryshme në Europë. Debatet e zhvilluara mes anëtarëve të AP-KE-së, kryesisht bazohen në atë që është zbuluar gjatë vizitave të drejtpërdrejta në terren, në vendet ku ndodhin krizat, por padyshim edhe në dialogun e vazhdueshëm e të pandërprerë me shtetet e interesuara. Kjo është mënyra e duhur për të përforcuar gjithkund, rolin politik të Këshillit të Europës.

Ishte pikërisht Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, që miratoi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Jo vetëm kaq, nga AP-KE janë dhe shumë tekste tjera që u kthyen në bazën kryesore të veprimeve të ndërmara nga organizata të ndryshme ndërkombëtare apo kombëtare. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, padyshim që ka rolin e rëndësishëm të vendimmarrjes, edhe në procesin e anëtarësimit, përjashtimit ose pezullimit të ndonjë shteti. Sipas rezolutës (51) 30A, miratuar më 3 maj 1951, Këshilli i Ministrave vendosi që, përpara se të ftonte një shtet të bëhej anëtar ose anëtar i asocuar i Këshillit të Europës, ose në rast të pezullimit ose përjashtimit të një anëtari, së pari do të konsultohet me Asamblenë²².

Profesionalizmi dhe roli i padiskutueshëm i këtij institucioni të lartë të BE-së, janë disa nga arsytet se përse është kaq shumë e rëndësishme, që përfaqësuesit e vendit në delegacionin e Asamblesë Parlamentare, të jenë njerëz të përkushtuar, me dinjitet, njerëz që i njohin në maksimumin e mundshëm marrëdhëniet ndërkombëtare, të tillë që mund t'i mbrojnë më së miri interesat e drejta të vendeve të tjera, por në rradhë të parë, të popullit të cilin e përfaqësojnë. (Skandali me Raportin e Dik Martit)

²² Olivier Costa, Clarissa Dri and Stelios Stavridis, *The Role of the Inter-parliamentary Institutions*, Palgrave Macmillan, UK, 2013, fq. 30

3.2 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË, NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË ORGANIZATËS SË SIGURISË DHE BASHKËPUNIMIT NË EUROPË (AP OSBE)

Asambleja Parlamentare e OSBE-së, është dimensionimi parlamentar i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Ajo përbëhet nga 57 shtete anëtare, që shtrihen nga Amerika e Veriut deri në Euroazi. Si dimension parlamentar i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, 57 Shtetet pjesëmarrëse të së cilës shtrihen në zonën gjeografike nga Vancouver në Vladivostok, detyra kryesore e 323 anëtarëve, është të lehtësojnë dialogun ndërparlamentar për të çuar përpara qëllimet e OSBE-së për sigurinë gjithëpërfshirëse²³.

Veprimtaria e OSBE-së është e ndarë në tri fusha bashkëpunimi: **1. Politik-ushtarak dhe të sigurisë, 2. Ekonomik- shkencor dhe ruajtjes së mjedisit dhe 3. Të drejtat e njeriut dhe të pakicave**²⁴.

Kjo Asamble, si qëllim parësor të saj ka nxitjen e bashkëpunimit mes parlamenteve nacionale, për aktivitetet e shumta të OSBE-së. Gjithsesi, detyrë parësore e kësaj Asambleje, është padyshim lehtësimi i dialogut, një aspekt ky tejet i rëndësishëm i përpjekjeve gjithëpërfshirëse për t'u përballur me sfidat e demokracisë. AP e OSBE-së, u themelua gjatë Samitit të vitit 1990 të zhvilluar në Paris. Nga organizatat e ndryshme kolektive multilaterale të sigurimit, OSBE ka ndoshta përkufizimin më të gjerë të sigurisë, duke përfshirë sigurinë njerëzore, sigurinë mjedisore dhe promovimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë.²⁵

Zgjedhjet në shtetet e ndryshme e sidomos vlerësimi i rregullsisë së procesit zgjedhor, është një nga detyrat e vazhdueshme të grupeve të delegatëve të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së.

Edhe RMV ka padyshim delegacionin e saj në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së. Ky delegacion përbëhet nga shefi i delegacionit, dy anëtarë dhe po aq zëvendës anëtarë. Shkupi ka qenë një herë edhe nikoqir i sesionit të 15 vjeshtor të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, në fund të shtatorit të vitit 2016. Në atë session, morrën pjesë mbi 50 delegacione të shteteve anëtare të OSBE-së.

²³ <https://www.oscepa.org/en/about-osce-pa/parliamentary-dimension-of-the-osce-> vizituar më 19.06. 2021

²⁴ A.Azizi, shënim ligjerate-“Institucionet Ndërkombëtare”, Tetovë, 15. Maj. 2021

²⁵ J.Samuel Barkin, *International Organization: Theories and Institutions*, Pallgrave Macmillan, New-York, 2006, fq. 73

3.3 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR (AP NATO)

Asambleja Parlamentare e NATO-s, është krijuar në vitin 1955. Themelimi i NATO-s, shënoi lindjen e një pakti të madh të mbrojtjes ndërmjet shteteve anëtare²⁶.

Asambleja Parlamentare e NATO-s, jo vetëm që mbështet parlamentet e vendeve anëtare në mbikëqyrjen e çështjeve që kanë të bëjnë kryekëput me mbrojtjen dhe sigurinë, por është njëkohësisht edhe një forum i rëndësishëm për ndërgjegjësimin rreth çështjeve që kanë ndikim në sigurinë e zonës Euro – Atlantike. Kjo Asamble, jep gjithashtu një ndihmesë të çmuar në përforcimin e marrëdhënieve transatlantike e njëkohësisht edhe në shkëmbimin e vlerave mes anëtarëve të Aleancës. Asambleja Parlamentare e NATO-s, veçanërisht seminarët e saj Ros-Roth, u përdorën për të socializuar parlamentarët nga ish vendet socialiste me normat “perëndimore” në një kohë kur, në prag të shembjes totale të normave dhe vlerave socialiste, parlamentarët e Lindjes u gjetën në një “vakum ideor”²⁷.

Edhe pse kjo Asamble Parlamentare, institucionalisht është e ndarë nga NATO, ajo luan rolin më të rëndësishëm në krijimin e urës lidhëse mes Aleancës Veri-Atlantike dhe parlamenteve të vendeve anëtare të saj.

Asambleja Parlamentare e NATO-s , ka në përbërjen e vet përfaqësues nga 30 shtetet anëtare të NATO-s.

Seicili prej këtyre delegacioneve, është një reflektim real dhe i qartë i përbërjeve politike të parlamenteve kombëtare të cilat ata përfaqësojnë, e si të tillë, ata sjellin në këtë Asamble një spektër të gjerë mendimi politik. Kjo është shumë pozitive , sepse krijon mundësi të mëdha për të promovuar vendin e për të krijuar miqësi e aleanca të forta.

Delegacioni i Maqedonisë së Veriut në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, përbëhet nga shefi i delegacionit, dy anëtarë dhe nga tre zëvendës anëtarë.

²⁶ Nathalie de Grove-Valdeyron, Said Hamdouni, *Institucionet Ndërkombëtare dhe Komunitare*, Congress Service Center, Shkup, 2006, fq.102

²⁷ Olivier Costa, Clarissa Dri and Stelios Stavridis, *The Role of the Inter-parliamentary Institutions*, Palgrave Macmillan, UK, 2013, fq. 29

3.4 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË KOMITETIN PARLAMENTAR PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Komiteti i Përzier Parlamentar RMV-BE, është një trup bilateral i themeluar sipas Rezolutës së Parlamentit të BE-së në vitin 2004, që u pasua nga vendim i Parlamentit të RM-së në të njëjtin vit, bazuar në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim të RMV-së me BE-në. Ky Komitet, si synim kryesor të qëllimit të funksionimit të tij, ka ndihmesën në procesin euro-integruar të vendit, nëpërmjet dialogut parlamentar dhe padryshim ndihmën që Parlamenti duhet të japë në arritjen sa më të shpejtë të standardeve për antarësimin e vendit në BE dhe arritjen e vlerave të Unionit.

Komiteti i përzier, mban takime dy herë në vit. Agjenda e takimeve të Komitetit të përzier, përqendrohet zakonisht në 4 deri në 6 tema të rëndësishme për marrëdhëniet dypalëshe. Pika e parë e agjendës, tradicionalisht ka të bëjë me marrëdhëniet dypalëshe dhe përgatitjet për negociatat e pranimit të vendit në BE. Komisioneri për Negociatat e Zgjerimit dhe një përfaqësues i lartë i qeverisë së Maqedonisë së Veriut, janë gjithmonë të ftuar të marrin pjesë dhe t'u drejtohen Anëtarëve²⁸. Delegacionin e Parlamentit të RMV-së në Komitetin e Përzier, e përbëjnë Kryetari i delegacionit, dy nënkryetarë, dhjetë anëtarë dhe dhjetë zëvendës anëtarë.

3.5 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË UNIONIN INTERPARLAMENTAR (UIP)

Unioni Interparlamentar (UIP), organizata multilaterale politike më e vjetër ekzistuese me seli në Gjenevë, u themelua në vitin 1889. Në UIP janë anëtarë 179 parlamente kombëtare dhe trembëdhjetë anëtarë të asociuar²⁹. Unioni Interparlamentar, ka statusin e vëzhguesit të përhershëm në OKB. Qëllimi kryesor i Unionit Interparlamentar, është, siç përshkruhet edhe nga vetë emri, mbarëvajtja e dialogut botëror parlamentar, por gjithashtu edhe paqja dhe bashkëpunimi mes popujve. Delegacioni i Kuvendit të RMV-së në Unionin Interparlamentar (UIP), ka gjashtë anëtarë.

²⁸ <https://www.europarl.europa.eu/delegations/en/d-mk/about/introduction-> vizituar më 23.06.2021

²⁹ <https://www.ipu.org/about-us-> vizituar më 20.06.2021

Shef i delegacionit është Kryetari i Parlamentit dhe anëtarët, zakonisht janë koordinatorët e grupeve parlamentare.

Unioni Interparlamentar është edhe promotori kryesor i zhvillimi të diplomacisë parlamentare.

3.6 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË DIMENSIONIN PARLAMENTAR TË INICIATIVËS SË EUROPËS QENDRORE (DP IEQ)

Iniciativa e Europës Qendrore, përbëhet prej 17 shteteve, kryesisht shtete të Europës Qendrore, Lindore dhe asaj Juglindore. 9 prej këtyre shteteve, janë anëtare të BE-së. Maqedonia u antarësua në këtë iniciativë në vitin 1993. Ajo ka kryesuar me DP IEQ dy herë, në vitin 2002 dhe në vitin 2015. Gjatë këtij kryesimi u organizuan edhe disa takime në Shkup. Iniciativa e Europës Qendrore ka si qëllim përforcimin e bashkëpunimit mes shteteve anëtare të saj, përshpejtimin e procesit të integritetit evropian përmes përkrahjes ndaj anëtarëve ekonomikisht të zhvilluara dhe anëtarëve që kanë nevojë për zhvillimin e shpejtë ekonomik, duke ndihmuar në përforcimin ekonomik, social dhe në aspekte të tjera juridike gjatë proceseve të tranzicionit etj. Dimensionin Parlamentar, së bashku me dimensionet Qeveritare dhe atë të Biznesit, është pozicionuar si një nga tre shtyllat e IEQ³⁰.

Delegacionin parlamentar të RMV-së në Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Europës Qendrore, përbëhet nga tre anëtarë dhe tre zëvendës anëtarë.

3.7 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË MESDHEUT (AP E MESDHEUT)

Asambleja Parlamentare e Mesdheut, është një organizëm ndërkombëtar relativisht i ri, me dimension multilateral. Ajo është vazhdimësi e dimensionit parlamentar të Konferencës për bashkëpunim në Mesdhe (CSCM), që funksionoi për shumë vite në suaza të Unionit Interparlamentar (UIP). Por vetëm nga shtatori i vitit 2006, Asambleja Parlamentare e Mesdheut filloi të funksionojë si organizatë e pavarur ndërkombëtare multilaterale. Parlamentet e vendeve të bregut të Mediteranit janë edhe anëtarët e Asamblesë Parlamentare të mesdheut. Asambleja

³⁰ <https://www.cei.int/parliamentary-dimension>, -vizituar më 20.06.2021

Parlamentare e Mesdheut, është forumi kryesor ku Parlamentet kombëtare të rajonit Euro-Mesdhetar, synojnë të arrijnë ato objektiva strategjikë drejt krijimit të mjedisit dhe kushteve më të mira politike, sociale, ekonomike dhe kulturore për bashkëqytetarët e vendeve anëtare ³¹

Asambleja Parlamentare e Mesdheut, ka si qëllim që t'i japë rëndësi më të madhe diplomacisë parlamentare në rajonin e Mesdheut, si dhe të përfshijë dhe avancojë dialogun ndërmjet kulturave.

Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në këtë Asamble, përbëhet prej 3 anëtarëve dhe 3 zëvendës anëtarëve.

3.8 DELEGACIONI I PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË PROCESIT PËR BASHKËPUNIM NË EUROPËN JUGLINDORE (AP PBEJL)

Procesi i bashkëpunimit në Europën Juglindore, nisi në Sofje , në vitin 1996, e kishte si qëllim transformimin e Europës Juglindore në një rajon të stabilitetit, sigurisë dhe bashkëpunimit. Qëllimet që çuan në krijimin e PBEJL-së, janë kryekëput në pajtueshmëri me rrjedhat drejt integritimit europian. Kjo arrihet përmes promovimit të dialogut dhe bashkëpunimit në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Asambleja Parlamentare e PBEJL, u krijua në Bukuresht në maj 2014, pas një procesi të gjerë konsultimesh që synonin transformimin dhe institucionalizimin e mëtejshëm të Dimensionit Parlamentar të PBEJL. Qëllimet e tij përfshijnë tema që lidhen drejtpërdrejt me rajonin e EJL, si dhe çështje aktuale në fushën e politikave europiane dhe integritimit europian. Gjeografia e AP PBEJL përfshin rajonin e Evropës Juglindore, duke përfshirë vendet anëtare të BE, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë³². Pjesëmarrës me të drejta të plota në process janë; Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Moldavia, Rumania, Serbia, Turqia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Kosova. RMV, në periudhën qershor 2000-2001 dhe periudhën qershor 2012-2013 , ishte kryesuese me PBEJL-në.

³¹ <https://www.pam.int/default.asp?>- vizituar më 21.06.2021

³² https://www.competition.rspcsee.org/en/About_SEECP_PA- vizituar më 20.06.2021

Delegacionin e Parlamentit në këtë Asamble , e udhëheq Kryetari i Parlamentit dhe ai ka edhe 4 anëtarë të tjerë dhe po aq zëvendës anëtarë.

3.9 DELEGACIONI I SEKSIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË FRANKOFONISË (APF)

Asambleja Parlamentare e Frankofonisë, u formua në maj të vitit 1967 në Luksemburg. Fillimisht pas themelimit nga Komiteti Konstituiv, ajo u emërtua si “Asociacioni i Parlamentarëve që e flasin gjuhën frënge” (AIPLF). Në korrik të vitit 1989, AIPLF riemërohet në “Asambleja Ndërkombëtare e parlamentarëve që e flasin gjuhën frënge”, e përfundimisht në korrik të vitit 1998 , ndryshoi emrin në atë që e mban edhe sot “ Asambleja Parlamentare e Frankofonisë “(Assemblée Parlementaire de la Francophonie – APF). Ajo pra është Asamble përfaqësuese e Frankofonisë dhe kuvend konsultues i saj.

Në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë janë anëtarë 56 seksione të parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës, nga vende ku gjuha frënge është gjuhë zyrtare, gjuhë e administratës, ose gjuhë që përdoret në përditshmëri, 15 seksione të asociuara të parlamenteve nga vendet ku gjuha frënge ka përdorim të pjesshëm në takime ndërkombëtare ose që mësohet në shkolla. Në këtë grup bën pjesë RMV dhe 19 seksione të Asambleve parlamentare ose këshilla të vendeve, krahinave, rajoneve dhe organizata ndërkombëtare me status të mbykqyrësit³³.

Seksioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë, si dhe Byroja e Seksionit dhe Delegacionit të Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë, janë themeluar në janar të vitit 2001. Delegacionin e seksionit të Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë, e përbëjnë 4 anëtarë.

³³ <https://apf.francophonie.org/-Les-membres-.html>- vizituar më 22.06.2021

3.10 GRUPET PARLAMENTARE PËR BASHKËPUNIM

Parlamenti i RMV-së, krijon edhe grupe për bashkëpunim bilateral mes parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës. Këto grupe ndryshe quhen edhe “Grupe për miqësi”. Qëllimi i këtyre grupeve parlamentare për miqësi është që nëpërmjet bashkëpunimit bilateral mes vendeve të ndryshme të botës, të krijohen marrëdhënie bashkëpunimi, të shkëmbehen përvojat dhe të krijohen raporte miqësore me vende të ndryshme, duke afirmuar kështu RMV-në në arenën ndërkombëtare.

Parlamenti i RMV-së ka formuar më shumë grupe bashkëpunimi me shumë parlamente të vendeve të ndryshme të botës. Por praktika tregon se këto grupe janë më shumë thjesht formale se sa grupe që realisht ndërmarin ndonjë veprim për bashkëpunim me vendet për të cilat janë të formuara. Vizitat e ndërsjella të këtyre grupeve parlamentare janë shumë të rralla. Aktiviteti më i shumtë i këtyre grupeve të bashkëpunimit, përfundon në takimet me përfaqësuesit e ambasadave të vendeve përkatëse ose në pjesmarje në eventet që këto ambasada organizojnë me rastin e festave të tyre shtetërore.

Grupet parlamentare për bashkëpunim përbëhen nga 7 anëtarë. Parlamenti i RMV-së ka formuar këto grupe parlamentare për bashkëpunim: Grupe parlamentare të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me Parlamentet e Republikës së Austrisë; Afganistanit; Azerbejxhanit; Australisë dhe Zelandës së Re; Shqipërisë, vendeve baltike; Belgjikës; Bosnjë e Hercegovinës; Bullgarisë; vendeve të Lindjes së Afërme dhe të Mesme; Gjermanisë; Greqisë; Danimarkës; Indisë; Indonezisë; Izraelit; Iranit; Irlandës; Islandës dhe Norvegjisë; Italisë; Japonisë; Kanadasë; Kazakistanit, Kirgistanit, Taxhikistanit, Uzbekistanit dhe Turkmenistanit; Kinës; Kosovës; vendeve të Amerikës Latine dhe të Karaibeve; Luksemburgut; Maltës dhe Qipros; Mongolisë; Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore; Polonisë; Portugalisë; Rumanisë; Rusisë; SHBA-së; Sllovakisë; Sllovenisë; Serbisë; Turqisë; Ukrainës; Hungarisë; Finlandës; Francës; Holandës; Kroacisë; Malit të Zi; Çekisë; Zvicrës; Suedisë dhe Spanjës³⁴.

³⁴ <https://www.sobranie.mk/pg-2020-2024.nspx-> vizituar më 23.06.2021

KAPITULLI –IV-

4. ROLI DIPLOMATIK I TRUPAVE PUNUES TË PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT NACIONAL PËR EUROINTEGRIME

Për shqyrtimin e propozimeve për miratimin e ligjeve, draft-ligjeve, propozim-ligjeve dhe akteve tjera të përgjithshme që miratohen nga Parlamenti, gjithashtu edhe për ndjekjen e zbatimit të akteve të Parlamentit dhe studimin dhe shqyrtimin e çështjeve tjera nga kompetenca e tij, Parlamenti i RMV-së themelon trupa të përhershëm punues. Trupat punues kanë kompetenca edhe për të vendosur bashkëpunim ndërkombëtar nga sferat për të cilat janë themeluar. Si trupa të përhershëm punues, Kuvendi themelon këto komisione:

- Komisioni për Çështje Kushtetuese, Komisioni Juridiko-Ligjvënës, Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri, Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Komisioni për Politikë të Jashtme, Komisioni për Çështje Europiane, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve, Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit, Komisioni për Mbikëqyrje mbi Punën e Agjencisë për Siguri Nationale dhe Agjencisë për Zbulim, Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve, Komisioni për Financim dhe Buxhet, Komisioni për Çështje Ekonomike, Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave, Komisioni për Transport, Lidhje dhe Ekologji, Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Sport, Komisioni për Kulturë, Komisioni për Shëndetësi, Komisioni për Punë dhe Politikë Sociale, Komisioni për Vetëqeverisje Lokale, Komisioni për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve dhe Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit Dhe Imunitetit³⁵.

Në këtë punim ne do të trajtojmë Komisionin për Politikë të Jashtme dhe Komisionin për Çështje Europiane, komisione këto që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe me diplomacinë.

Që nga viti 2007, Parlamenti i RMV-së ka themeluar Këshillin Nacional për Eurointegritime, i cili ndihmon në plotësimin e kriterëve për anëtarësimin e vendit në Bashkimin European. Këshilli Nacional për Eurointegritime, debaton dhe miraton konkluzionet dhe rekomandimet për shumë çështje, që përfshijnë shqyrtimin e raportit të Komisionit European për Maqedoninë e Veriut por

³⁵ <https://www.sobranie.mk/rabotni-tela-2020-2024.nspj>- vizituar më 10.06.2021

dhe çështje të tjera të rëndësishme të lidhura ngushtë me aktivitete për anëtarësimin e RMV-së në BE.

4.1 KOMISIONI PËR POLITIKË TË JASHTME

Komisioni për Politikë të Jashtme, shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të RMV-së dhe marrdhëniet me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare. Këtë komision e përbëjnë Kryetari, zëvendësi i tij, 12 anëtarë dhe po aq zëvendës anëtarë. Komisioni për Politikë të Jashtme shqyrton edhe çështje të tjera tjera të ndërlidhura me nevojën e fillimit të negociatave, shqyrton lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, bilaterale ose multilaterale, përkatësisht platformat rreth këtyre negociatave; shqyrton ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare; rregullativën ndërkombëtare nga sfera e të drejtave dhe lirive të njeriut, dokumentet e organizatave dhe asociacioneve ndërkombëtare. Komisioni shqyrton edhe vendosjen e bashkëpunimit parlamentar me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare; vendosjen e bashkëpunimit me Komisionet për Politikë të Jashtme të parlamenteve të shteteve tjera.

Komisioni ngre iniciativa dhe propozime për definimin e strategjisë së politikës së jashtme dhe merret edhe me çdo çështje tjetër që lidhet me politikën e jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4.2 KOMISIONI PËR ÇËSHTJE EUROPIANE

Komisioni për Çështje Europiane, përbëhet nga 12 anëtarë dhe zëvendësit e tyre. KÇE shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Nacionale për Eurointegrim të RMV-së në Bashkimin Evropian. Komisioni e ka për obligim që të informojë rregullisht parlamentin rreth zbatimit të kësaj strategjie, e njëkohësisht, të ndjekë edhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga marrëveshjet e nënshkruara mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian. Gjithashtu ndjek dhe informon edhe rreth realizimit të programeve dhe akteve të institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, përfshirë këtu edhe programet për ndihmë financiare.

Komisioni për Çështje Europiane ndjek dhe nxit njëkohësisht, edhe procesin e harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me atë të Bashkimit Evropian. Ai propozon masa shtesë që ndihmojnë në progresin e procedurave të harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të Unionit, jep edhe mendime e propozime për aktivitetet e trupave të tjerë punues të Kuvendit, duke poentuar vëmendjen në çështjet që kanë të bëjnë me antarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Komisioni për Çështje Europiane ndjek gjithashtu me vëmendje të gjitha aktivitetet e Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore në lidhje me antarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Për të gjitha këto çështje, ky komision jep mendime dhe rekomandime. Komisioni bashkëpunon ngushtë me komisionet e vendeve të tjera.

4.3 KËSHILLI NACIONAL PËR EUROINTEGRIME

Këshilli Nacional për Eurointegritime, u themelua në nëntor të vitit 2007. Themelimi i këtij këshilli doli si domosdoshmëri e periudhës kur vendi i vuri vetes si përcaktim strategjik, anëtarësimin në Bashkimin Evropian, që ishte jo vetëm strategji e politikës, por kishte edhe mbështetjen e plotë të qytetarëve. Këshilli ndjek me vëmendje kriteret të cilët duhen plotësuar dhe përmbushjen e obligimeve nga institucionet kompetente. Këshilli Nacional për Eurointegritime debaton dhe miraton konkluzione dhe rekomandime për shumë çështje të rëndësishme, përfshirë shqyrtimin e raportit të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut. Këshilli gjithashtu përgadit edhe analiza e mendime që kanë të bëjnë me integrimin e vendit në BE.

Këshilli përbëhet nga kryetari, nënkryetari, 15 anëtarë dhe nëntë zëvendës anëtarë, që zgjidhen sipas një metode të përcaktuar qartë: 9 anëtarë të tij vijnë nga radhët e deputetëve në Kuvendin Republikan e ata kanë zëvendësit e tyre, padyshim duke ruajtur përfaqësimin e barabartë mes deputetëve të pushtetit dhe opozitës. 6 anëtarë zgjidhen nga institucionet e tjera. Këta anëtarë të “jashtëm” janë: zëvendëskryetari i Qeverisë, i ngarkuar për çështjet europiane, një përfaqësues nga Kabineti i Presidentit të RMV-së, një përfaqësues nga Kabineti i Kryetarit të Qeverisë, një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Arteve, një përfaqësues nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe një përfaqësues nga Shoqata e Gazetarëve. Këta 6 anëtarë, marrin pjesë në punën e Këshillit, por pa të drejtë të vendosjes. Gjithashtu pa të drejtë vendosjeje, në

këtë keshill marrin pjesë edhe përfaqësues nga odat ekonomike, sindikatat, platforma qytetare dhe bashkësitë fetare.

Kryetari i Këshillit emërohet nga radhët e deputetëve të opozitës, ndërsa nënkryetari nga radhët e deputetëve të partive në pushtet.

Vendimet Këshilli i merr me konsensus të anëtarëve të pranishëm nga radhët e deputetëve, të cilët kanë të drejtë për të votuar.

KAPITULLI-V-

5. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË

Në vijim do të prezentojmë të dhëna për aktivitetet ndërkombëtare dhe diplomatike të delegacioneve të Parlamentit të RMV-së dhe të grupeve për bashkëpunim të Parlamentit, për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Të dhënat do t'i prezentojmë në formë tabelash, me të dhëna që janë siguruar nga Raportet Vjetore të Parlamentit dhe me grafikone të përpunuara, ku do të paraqesim aktivitetet multilaterale dhe bilaterale të Parlamentit të RMV-së.

5.1 PREZANTIMI I TË DHËNAVE NGA AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË

Për vitet, të dhënat e të cilave do t'i prezentojmë në këtë punim, kanë ndikuar shumë edhe ngjarjet që i shënuan këto vite. RMV nisi vitin 2018, me akuzat e kundërakuzat që pasuan zgjedhjet lokale të zhvilluara në tetor të vitit 2017. Në RMV, për vite me rradhë, zgjedhjet nuk janë më zgjidhje e problemeve nga pushteti i mëparshëm, por ato prodhojnë kriza dhe pakënaqësi shtesë. Gjatë gjithë vitit 2018, Maqedoninë do ta ndjekin problemet e brendshme politike, e në fillim të verës, vjen edhe një ngjarje që bëri një kthesë të rëndësishme në mardhëniet e vendit me Greqinë. Në qershor të 2018-s, u nënshkrua Marrëveshja e Prespës. Kjo marrëveshje që zgjidhi një kontest shumëvjeçar me një shtet fqinj, solli jo pak probleme në vend, në veçanti në bllokun politik maqedonas. Procesi prej te nënshkrimi, mbajtja e referendumit e deri te ratifikimi i Marrëveshjes në Parlamentin e RMV-së, kaloi përmes problemeve të shumta. Marrëveshja u ratifikua në fund, falë përkrahjes së diplomacisë amerikane dhe europiane dhe falë shqiptarëve. Edhe viti 2019, e gjeti Maqedoninë me probleme të brendshme. Po për dallim nga 2018, në janar të vitit 2019 Parlamenti miratoi amandamentet për ndryshimet Kushtetuese për ndërrimin e emrit. Viti 2019 ishte edhe vit zgjedhor, sepse në prill u mbajtën zgjedhjet presidenciale. Edhe pse me probleme tradicionale të brendshme, në aspektin e punëve të jashtme dhe diplomacisë, 2019-a ishte vit me shumë aktivitete sepse në këtë vit, shumë vende anëtare të NATO-s ratifikuan protokollet për anëtarësim të RMV-së në NATO. Viti 2020 ndërkohë, ishte vit me shumë probleme për diplomacinë parlamentare në RMV. Problemet në vitin 2020 kishin

të bëjnë me Pandeminë e shkaktuar nga virusi COVID-19 në njërën anë, e në anën tjetër, me “sëmundjet kronike” që RMV ka kur bëhet fjalë për problemet e brendshme politike. Sikur të mos mjaftonte Pandemia, në RMV në 2020-n, u mbajtën edhe zgjedhjet parlamentare. Parlamenti votoi për shpërndarjen e tij më 16 shkurt 2020. Zgjedhjet fillimisht duhej të mbaheshin më 12 Prill, por për shkak të Pandemisë, ato u shtynë për më 15 Korrik. Përbërja e re parlamentare, u konstituua më 4 gusht. Pra, pjesën më të madhe të vitit 2020, në krizën më të madhe shëndetësore që njeh bota moderne, Parlamenti i Maqedonisë së Veriut, ishte i shpërndarë, pra jo funksional, për një periudhë të gjatë, që nga shkurti e deri në gusht. Kjo flet shumë për joseriozitetin e aktorëve politikë, sidomos të atyre që kanë më shumë përgjegjësi, ata që udhëheqin me pushtetin. Krejt këto që përmendëm kanë ndikuar edhe në aktivitetet diplomatike të Parlamentit. Por megjithatë, duhet patjetër të theksojmë, se vetëm falë diplomacisë dhe përkrahjes së SHBA-ve dhe BE-së, Maqedonia e Veriut, edhe përkundër problemeve të brendshme të shumta e në veçanti problemet që shqiptarët vazhdojnë t’i kenë , në aspektin strategjik, ecën atje ku duan shqiptarët dhe shumica e qytetarëve, në NATO dhe drejt proceseve euro-integruese.

Të dhënat tabelare kanë të bëjnë me aktivitetet multilaterale të delegacioneve të Parlamentit të RMV-së, me aktivitetet bilaterale të Grupeve për Bashkëpunim dhe për aktivitete të tjera.

5.1.1 AKTIVITETET MULTILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-SË PËR VITIN 2018

Parlamenti i RMV-së, për bashkëpunim multilateral, në mandatin 2017-2020 formoi 9 delegacione në këto organizata ndërkombëtare: Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (AP KE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë (AP OSBE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (AP NATO), Unionin Interparlamentar (UIP), Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Europës Qendrore (DP IEQ), Asamblenë Parlamentare të Mesdheut (AP e Mesdheut) dhe Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore (AP PBEJL). Delegacionet, në të shumtën e rasteve, përbëhen nga tre anëtarë dhe po aq zëvendës. Më shumë anëtarë ka Komiteti për Stabilizim dhe Asociim, që përbëhet nga Kryetari, 2 nënkryetarë, 10 anëtarë dhe 10 zv/anëtarë.

TABELA NR.1

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS (AP KE) PËR VITIN 2018³⁶				
N r.	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	22-26 Janar	Pjesa e Parë e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP KE-së	Strazburg
2	1 Shkurt	Vizitë Zyrtare e Komisarit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së, Anëtarë të Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit të Parlamentit të RMV-së dhe deputetë, pjesëtarë të komunitetit rom.	Shkup
3	16 Mars	Mbledhje e Komisionit të Përhershëm dhe Komisionit Ad-Hoc, për rolin dhe misionin e AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris
4	27 Mars	Takim me Delegacionin e Konferencës së Organizatave Joqeveritare pranë Këshillit të Europës	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Shkup

³⁶ www.sobranie.mk- "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

5	22-27 Prill	Pjesa e Dytë e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
6	18-20 Qershor	Vizitë e Komisionit Monitorues në kuadër të dialogut post-monitorues	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Shkup
7	8-12 Tetor	Pjesa e katërt e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
8	6 Nëntor	Konferencë e Përbashkët e Komisionit për Çështje Politike dhe të Demokracisë të AP të KE-së dhe Parlamentit të Kroacisë, me temë “Ndërtimi i sigurisë demokratike të Mesdheut”	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Dubrovnik
9	14 Dhjetor	Takim i rregullt vjetor i Sekretarëve të Delegacioneve Nacionale në AP të KE-së	Sekretari i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris

TABELA NR.2

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË OSBE-SË (AP OSBE) PËR VITIN 2018³⁷				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	22-23 Shkurt	Sesioni Dimëror i AP të OSBE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Vienë
2	13-14 Mars	Konferencë Ndërkombëtare e “Grupit për përkrahje të Rugës së Mëndafshit” të AP të OSBE-së, me temë: “Roli i deputetëve në nxitjen e bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor përgjatë Rugës së Mëndafshit”	Anëtarë e Delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Baku
3	4 Qershor	Takim me Ambasadorin e R. Sllovakisë në RMV për pregaditjet e kryesimit së ardhshëm të R.Sllovakisë me OSBE-në	Anëtarë të Delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Shkup
4	7-12 Korrik	Sesioni Vjetor i 27 i AP të OSBE-së dhe Seminari “Leinsweiler”	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Berlin

³⁷ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

5	15-16 Nëntor	Konferencë e organizuar nga AP të OSBE-së dhe Senati i Spanjës për viktimat nga terrorizmi	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Madrid
----------	--------------	--	--	--------

TABELA NR.3

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË UNIONIN INTER PARLAMENTAR (IUP) PËR PERIUDHËN VITIN 2018³⁸				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	23-29 Mars	Kuvendi i 138 i Unionit Inter Parlamentar	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në UIP	Gjenevë
2	24-25 Maj	Seminar për vendet e Europës Lindore dhe Qendrore	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në UIP	Beograd
3	10-12 Shtator	Seminar Parlamentar i UIP për vendet e Ballkanit Perëndimor	Deputetë të Parlamentit të RMV-së	Londër

TABELA NR.4

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË DIMENSIONIN PARLAMENTAR TË INICIATIVËS SË EUROPËS QENDRORE (DP IEQ) PËR VITIN 2018³⁹				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	15-16 Maj	Sesioni i rregullt pranveror i Komitetit të Delegacioneve Parlamentare në DP IEQ	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në DP IEQ	Zagreb
2	27-28 Nëntor	Sesioni i rregullt i vjeshtës i Komitetit të Delegacioneve Parlamentare në DP IEQ	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në DP IEQ	Zagreb

³⁸ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

³⁹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

TABELA NR.5

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-s (AP NATO) PËR VITIN 2018⁴⁰				
N r.	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	5-6 Shkurt	Vizitë pune e drejtorit politik në AP të NATO-s, rreth përgatitjes së Seminarit të 98, “Ros-Rot”, që u mbajt në RMV më 27-29 Qershor 2018.	Kryetari i Parlamentit dhe delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Shkup
2	25-28 Maj	Sesioni pranveror i AP të NATO-s	Delegacion i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Varshavë
3	27-29 Qershor	RMV nikoqir i Seminarit të 98 “Ros-Rot” me temë: ”Integrimi Euro-Atlantik i Ballkanit Perëndimor,përforcim i projektit të paqes në Europë”	Kryetari i Parlamentit dhe Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Shkup
4	16-19 Nëntor	Sesioni i 64-t vjetor i AP të NATO-s	Kryetari i Parlamentit (kishte edhe fjalim) dhe delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Halifaks-Kanada

TABELA NR.6

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË MESDHEUT (AP MESDHEUT) PËR VITIN 2018⁴¹				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	15-16 Shkurt	Sesioni i 12 i AP të Mesdheut	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të Mesdheut	Bukuresht

⁴⁰ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

⁴¹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

TABELA NR.7

AKTIVITETET E SEKSIONIT TË DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË FRANKOFONISË (AP FRANKOFONISË) PËR VITIN 2018⁴²				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	21-23 Mars	Mbledhje e Komisionit për Çështje Parlamentare	Anëtare e delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP-të Frankofonisë	Bruksel
2	3-4 Maj	Në selinë e FAO-s(Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e OKB-së), mbledhje e Komisionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim e Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë	Anëtare e delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP-të Frankofonisë	Romë
3	21-22 Maj	Konferencë e kryetarëve të seksioneve të AP të Frankofonisë	Kryetar i seksionit të delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të Frankofonisë	Bukuresht

TABELA NR.8

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT NË EUROPËN JUGLINDORE (AP PBEJL) PËR VITIN 2018⁴³				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	10 Mars	Mbledhje e Komitetit Gjeneral për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energji e AP PBEJ	ZV-Anëtar i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të PBEJ-së	Stamboll
2	16-17 Mars	Mbledhje e komitetit të përhershëm të AP të PBEJ-së në kuadër të kryesimit të R. Sllovenisë me AP të PBEJ-së	Anëtar i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP-të PBEJ-së	Bled-Slloveni
3	13-14 Prill	Sesioni i 5 vjetor i AP të PBEJ-së	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP	Lublanë

⁴² www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

⁴³ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

			të PBEJ-së	
4	1 Dhjetor	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm të AP të PBEJ-së	Zvçkordinatori nacional i AP të PBEJ-së	Sarajevë

TABELA NR.9

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË KOMITETIN PARLENTAR PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM PËR VITIN 2018⁴⁴				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	6-7 Shkurt	Takimi i 14 i Komitetit të Përzier Parlamentar BE-RMV	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim	Strazburg
2	19-20 Shtator	Takimi i 15 i Komitetit të Përzier Parlamentar BE-RMV	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim	Shkup ⁴⁵


Nga paraqitja tabelare e të dhënave për aktivitetet multilaterale të delegacioneve të Parlamentit në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, mund të konstatojmë se më aktiv ndër delegacionet e Parlamentit të RMV-së në aktivitete diplomatike, është delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, i cili, për vitin 2018, ka zhvilluar 9 aktivitete që kryesisht kanë të bëjnë me pjesëmarrje në sesione të rregullta të Asamblesë, konferenca, mbledhje të komisioneve, takimeve të ndryshme. Disa nga këto takime janë zhvilluar edhe në Shkup. Gjithashtu, për nga rëndësia dhe aktiviteti, janë edhe aktivitetet e delegacioneve të Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së dhe në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, për vitin 2018, ka zhvilluar 5 aktivitete, kurse ai i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ka zhvilluar 4 aktivitete. Delegacionet e tjera janë më pak aktivë, kryesisht për vitin 2018 kanë zhvilluar nga 3 ose 2 aktivitete. Më dobët me aktivitete për vitin 2018, ka qenë Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të Mesdheut, i cili ka zhvilluar vetëm një aktivitet. Nëse

⁴⁴ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

⁴⁵ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

bëjmë një përmbledhje përgjithësuese të aktiviteteve multilaterale të delegacioneve të Parlamentit të RMV-së në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, del se për vitin 2018, delegacionet e Parlamentit kanë zhvilluar 33 aktivitete multilaterale, që kryesisht kanë të bëjnë me seanca të rregullta vjetore, konferenca të ndryshme ndërkombëtare, mbledhje të komisioneve të ndryshme, seminare, takime të niveleve të ndryshme, vizita etj.

GRAFIKONI NR.1



5.1.2 AKTIVITETET BILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-së PËR VITIN 2018

Parlamenti i RMV-së për bashkëpunim bilateral, formon grupe për bashkëpunim me parlamentet e vendeve tjera. Këto grupe ndryshe quhen edhe “Grupe të miqësisë”. Gjatë mandatit 2017-2020, Parlamenti i RMV-së formoi 46 grupe për bashkëpunim edhe atë: Grupe parlamentare të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me Parlamentet e Republikës së Austrisë; Australisë dhe Zelandës së Re; Shqipërisë, vendeve baltike; Belgjikës; Bosnjë e Hercegovinës; Bullgarisë; vendeve të Lindjes së Afërme dhe të Mesme; Gjermanisë; Greqisë; Danimarkës; Indonezisë; Izraelit; Iranit; Irlandës; Islandës dhe Norvegjisë; Italisë; Japonisë; Kanadasë; Kinës; Kosovës; vendeve të Amerikës Latine dhe të Karaibeve; Luksemburgut; Maltës dhe Qipros; Mongolisë; Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore; Polonisë; Portugalisë; Rumanisë; Rusisë; SHBA-së; Sllovakisë; Sllovenisë; Serbisë; Turqisë;

Ukrainës; Hungarisë; Finlandës; Francës; Holandës; Kroacisë; Malit të Zi; Çekisë; Zvicrës; Suedisë dhe Spanjës. Këto grupe përbëhen nga 7 anëtarë.

TABELA NR.10


AKTIVITETET E GRUPEVE PARLAMENTARE PËR BASHKËPUNIM PËR VITIN 2018⁴⁶				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	28 Shkurt	Vizitë në RMV e Delegacionit të përbërë nga biznesmenë nga Arabia Saudite	Kryetari i Parlamentit, Grupi për bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me vendet e Lindjes së Afërt dhe të Mesme	Shkup
2	20-22 Mars	Vizitë zyrtare në R. e Bullgarisë	Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Bullgarinë	Sofje
3	22-23 Mars	Vizitë e deputetës së Parlamentit të Francës, njëkohësisht nënkryetare e Komisionit për Çështje Europiane dhe nënkryetare e Grupit Parlamentar për Miqësi me RMV-në	Kryetari i Parlamentit, kryetari i Komisionit për Çështje Europiane dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën dhe delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të Frankofonisë	Shkup
4	16-18 Prill	Vizitë e delegacionit të Senatit të R.Çeke, i udhëhequr nga nënkryetari i Senatit	Nënkryetarja e Parlamentit të RMV-së, Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Çekinë, kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme, Komisionit për Çështje Europiane dhe Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri	Parlamenti i RMV-së, Shkup
5	19-20 Mars	Vizitë zyrtare në R.Turqisë, takim	Kryetari i Parlamentit dhe delegacioni i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Turqinë	Ankara
6	11 Prill	Vizitë zyrtare e MPJ të Ukrainës në RMV-takim	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Ukrainën	Shkup
7	4 Maj	Takim me Ambasadorin e Italisë në RMV	Kryetari i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Italinë	Shkup
8	29-30 Maj	Vizitë kthyesë në Ukrainë	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Ukrainën	Kiev

⁴⁶ www.sobranie.mk- "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

9	6 Qershor	Takim me Ambasadorin e R.P. të Kinës në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Kinën	Ambasada e Kinës-Shkup
10	7 Shtator	Takim me Senatorin nga Senati i R. Francës, përfaqësues i shtetasve francezë që jetojnë jashtë Francës, i shoqëruar nga Ambasadori i Francës në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën	Shkup
11	25 Shtator	Vizitë pune në RMV i Delegacionit të Parlamentit Slloven, i udhëhequr nga Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit të RMV-së, Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Slloveninë, kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane	Shkup
12	21-23 Tetor	Vizitë zyrtare në R.e Çekisë	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Çekinë	Pragë
13	15 Nëntor	Takim me Ambasadorin e R.P. të Kinës në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Kinën	Shkup
14	21 Nëntor	Takim me Ambasadorin e Kuvajtit në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me vendet e Lindjes së Afërt dhe të Mesme	Shkup
15	6 Dhejtor	Takim me delegacionin për përzgjedhje të stipendistëve për Bursat Ndërkombëtare Parlamentare në Budestagun Gjerman	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Gjermaninë	Shkup
16	10 Dhjetor	Vizitë zyrtare e Kryetarit të Parlamentit të R. së Shqipërisë, takim	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Shqipërinë	Shkup
17	14 Dhjetor	Shënimi i 25 vjetorit i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Britaninë e Madhe	Shkup
18	18 Dhjetor	Vizitë e ministrit për Çështje Evropiane të R.së Rumanisë	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe kryetari i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Rumaninë	Shkup
19	24 Dhjetor	Takim me Ambasadorin e Federatës Ruse në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Rusinë	Parlamenti i RMV-së, Shkup

Të dhënat tabelare tregojnë se Grupet Parlamentare për bashkëpunim bilateral me vendet e tjera, ka realizuar 19 aktivitete. Kryesisht, grupet parlamentare këto aktivitete i kanë zhvilluar në Parlamentin e RMV-së dhe vetëm disa kanë qenë aktivitete jashtë RMV-së. Nga të dhënat mund të konstatojmë, se aktivitetet e grupeve për bashkëpunim bilateral, janë jo të mjaftueshme. Marrë parasysh se janë krijuar 46 grupe për bashkëpunim, dhe kur e krahasojmë këtë të dhënë me numrin e aktiviteteve të zhvilluara, mund të konkludojmë se këto grupe janë shumë pak aktive. Edhe ato aktivitete që i realizojnë, janë më së shumti të natyrës protokollare, pritje të delegacioneve që vizitojnë vendin ose takime me ambasadorë të akredituar në vendin tonë.

GRAFIKONI NR.2



5.1.3 AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE BE- PARLAMENTI I RMV-së PËR VITIN 2018

RMV, si vend kandidat për anëtarësim në BE, zhvillon aktivitete të ndryshme, të cilat kanë si qëllim kryesor përkrahje të vendit që sa më parë të integrohet në BE. Edhe Parlamenti i RMV-së zhvillon aktivitete të ndryshme me Parlamentin e BE-së. Këto aktivitete kanë të bëjnë me vizita të ndryshme studimore, konferenca, takime dhe aktivitete tjera.

TABELA NR.11


AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE- RMV- BEçPARLAMENTI EUROPIAN PËR VITIN 2018⁴⁷				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	22-23 Janar	Vizitë studimore në kuadër të programit të Parlamentit të BE-së për përkrahje të Paramenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë	Delegacion i deputetëve të rinj nga Parlamenti i RMV-së	Bruksel
2	26 Shkurt	Konferencë Interparlamentare me temë: “Fuqia e kasës: kompetencat dhe procedurat buxhetore të Parlamentit të BE-së”	Deputetë nga Parlamentet e vendeve kandidate për në BE	Shkup
3	23 Mars	Takim me delegacionin e Grupit të Partisë Popullore Europiane në Parlamentin e BE-së	Kryetari i Parlamentit të RMV-së	Shkup
4	13 Prill	Konferencë Interparlamentare nën organizimin e Parlamentit të BE-së dhe Parlamentit të Serbisë me temë:”Instrument për ndihmë paraqasëse në zhvillimin rural: Mësimet e nxjerra dhe perspektivat e së ardhmes”	Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Ujëra i Parlamentit të RMV-së	Beograd
5	23 Prill- 1 Qershor	Programi për stazhistë në Parlamentin e BE-së	Pjesëmarje në këtë program si stazhiste- një e punësuar në Parlamentin e RMV-së	Bruksel
6	15 Qershor	Konferencë Interparlamentare nën organizimin e Parlamentit të BE-së dhe Parlamentit të R. Çeke me temë:”Respektimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së medimeve në BE dhe më gjerë”	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së	Pragë
7	20 Shator	Dialog i nivelit të lartë për pjesëmarje politike të të rinjve dhe politikat rinore	Deputetë nga Parlamenti i RMV-së	Shkup
8	4 Tetor	Takim i rregullt i Kordinatorëve Nacional në Parlamentin e BE-së	Kordinatori Nacional i RMV-së në Parlamentin e BE-së	Sofje
9	5 Tetor	Konferencë Ndërpamentare me temë:”Transformimi i rajonit të Ballkanit Perëndimor- perspektivë parlamentare për rolin dhe ardhmërinë e procesit për anëtarësim në BE”	Delegacion nga Parlamenti i RMV-së	Sofje
10	19-20 Nëntor	Konferencë e Komisionit ndërpamentar të Parlamentit	Kryetarja e Komisionit për Kulturë në Parlamentin e	Bruksel

⁴⁷ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

		të BE-së me temë: "Trashëgimia kulturore Europiane"	RMV-së	
11	27 Nëntor	Tryezë e rumbullakët e nivelit të lartë për proceset e eurointegritit të Ballkanit Perëndimor	Deputetë nga Parlamenti i RMV-së	Bruksel

Parlamenti i RMV-së, për vitin 2018, ka zhvilluar 11 aktivitete në bashkëpunim me Parlamentin e Bashkimit Europian. Këto aktivitete kanë të bëjnë me organizimin e vizitave studimore, konferencave, takimeve, tryezave të rumbullakëta etj. Shumica e aktiviteteve janë zhvilluar jashtë RMV-së në Bruksel, Sofje, Beograd, ndërsa në Shkup janë zhvilluar vetëm 3 aktivitete. Marrë parasysh rëndësinë e madhe që paraqesin euro-integritet për vendin tonë në njërin anë, e në anën tjetër aktivitetet e Parlamentit për këtë qëllim, vërejmë se Parlamenti i RMV-së zhvillon aktivitete të pakta dhe dukshëm mungojnë iniciativat. Aktivitetet kryesisht i organizon BE-ja, kurse parlamenti i RMV-së merr pjesë në këto aktivitete, vetëm kur e ftojnë.

GRAFIKONI NR.3



5.1.4 AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2018

Parlamenti i RMV-së zhvillon edhe aktivitete të tjera, që kanë karakter ndërkombëtar. Merr pjesë në shumë aktiviteteve të nismave rajonale, që kanë si qëllim thellimin e bashkëpunimit të vendeve të rajonit në fusha të ndryshme, qofshin ato politike, ekonomike apo të çështjeve të sigurisë. Parlamenti bashkëpunon edhe me organizata ndërkombëtare të tjera, qofshin ato me

karakter ndërqeveritar, ose organizata ndërkombëtare joqeveritare, të cilat e ndihmojnë shumë parlamentin në përforcimin e kapaciteteve diplomatike dhe të tjera.


TABELA NR.12

AKTIVITETE TJERA NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2018⁴⁸				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	12-13 Korrik	Konferencë Parlamentare për mundësitë e lehtësimeve tregtare dhe investimeve në rajonin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Mesdheut , e organizuar nga Parlamenti i Serbisë dhe AP e Mesdheut	Komisioni për Çështje Ekonomike në Parlamentin e RMV-së	Beograd
2	18-19 Tetor	Komiteti i punës për integrimin e RMV-së në NATO, bisedime paraqasëse për anëtarësim në NATO	Ndihmës udhëheqës i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Parlamentit të RMV-së dhe Sekretari i Delegacionit të RMV-së në AP të NATO-s	Bruksel
3	1 Nëntor	Sesioni i 71-të i Komitetit të KB-së për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas	Deputete e Parlamentit të RMV-së, pjesë e delegacionit të RMV-së të udhëhequr nga ministrja e punës dhe politikave sociale dhe nga ministri i shëndetësisë	Gjenevë
4	15-23 Shkurt	Vizitë e stipendistëve të përzgjedhur prej RMV nga Praktikumi Parlamentar i R.Gjermanisë	Takim me Kryetarin e Parlamentit të RMV-së dhe Sekretarin e Parlamentit të RMV-së	Shkup
5	6 Dhjetor	Takim me anëtarët e Komisionit të Bundestagut Gjerman për përzgjedhjen e stipendistëve nga RMV për programin:” Bursa Ndërkombëtare Parlamentare- Praktikumi Parlamentar”	Kryetari i Parlamentit të RMV-së , Sekretari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Miqësi i Parlamentit të RMV-së me Gjermaninë	Shkup


⁴⁸ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018

Parlamenti i RMV-së, gjatë vitit 2018 ka zhvilluar 5 aktivitete të tjera ndërkombëtare. Aktivitetet e zhvilluara janë të ndryshme. 3 nga këto aktivitete janë zhvilluara jashtë RMV-së dhe 2 në Shkup. Edhe rreth aktiviteteve të ndryshme, vërehet se mungon iniciativa nga ana e Parlamentit të RMV-së për të qenë më aktiv në këto aktivitete.

GRAFIKONI NR.4



GRAFIKONI NR.5



5.1.5 AKTIVITETET MULTILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-së PËR VITIN 2019

Parlamenti i RMV-së, në vitin 2019, formoi 9 delegacione për bashkëpunim multilateral me organizatat ndërkombëtare. Delegacionet e Parlamentit të RMV-së për bashkëpunim multilateral për vitin 2019, janë po ato që ishin edhe në 2018-n. Delegacionet zakonisht formohen në fillim të përbërjes së re parlamentare dhe mbeten pothuajse të pandryshuara gjatë gjithë përbërjes parlamentare. Eventualisht mund të ndodhë që të ketë ndryshime në përbërje të delegacioneve, kur për shkaqe të ndryshme, të ndërrohet ose zëvendësohet ndonjë anëtar i delegacionit me një anëtar tjetër. Në mënyrë tabelare dhe me grafikone, do të paraqesim aktivitetet multilaterale të delegacioneve të Parlamentit të RMV-së në organizatat ndërkombëtare për vitin 2019.

TABELA NR.13

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EuROPËS (AP KE) PËR VITIN 2019⁴⁹				
Nr.	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	21.-25 Janar	Pjesa e parë e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP KE-së	Strazburg
2	8-12 Prill	Pjesa e dytë e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
3	24 Maj	Takim i Komitetit të Përhershëm të AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris
4	23-28 Qershor	Pjesa e tretë e Sesionit të rregullt të AP të KE-së	Anëtar i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
5	10 Shtator	Mbledhje e Komitetit Monitorues të AP të KE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris
6	30 Shtator-4 Tetor	Pjesa e katërt e Sesionit të rregullt të AP të KE	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
7	13-14 Nëntor	Konferencë e Komisionit Monitorues të AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Strazburg
8	5-6 Dhjetor	Takim i Komisionit për Kulturë, Arsim-Shkencë dhe Medime të AP të KE-së	Anëtare e delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris
9	11 Dhjetor	Takim i Komisionit Monitorues të AP të KE-së	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris

⁴⁹ www.sobranie.mk - "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

10	13 Dhjetor	Takim i rregullt i Sekretarëve të delegacioneve	Ko-sekretari i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Paris
-----------	------------	---	---	-------

TABELA NR.14

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË OSBE-SË (AP OSBE) PËR VITIN 2019⁵⁰				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	20-22 Shkurt	Sesioni dimëror i AP të OSBE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Vjenë
2	4- 8 Korrik	Sesioni vjetor i AP të OSBE-së	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Luksemburg

TABELA NR.15

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-s (AP NATO) PËR VITIN 2019⁵¹				
Nr.	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	3-5 Shkurt	Me ftesë të AP të NATO-s, Vizitë studimore shtabit të NATO-s	-Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s, -Delegacioni i Parlamentit të RMV-së nga Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri dhe nga Komisioni për Politikë të Jashtme në Kuvendin e RMV-së	Bruksel
2	18-20 Shkurt	Me ftesë të AP të NATO-s, pjesëmarrje në mbledhjet e Komitetit të AP të NATO-s me Këshillin Veri Atlantik (NAC)	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Bruksel
3	1 Mars	Me ftesë nga Parlamenti i Kroacisë, pjesëmarrje në seancën ku ratifikohej Protokollin për Anëtarësim të RMV-së në NATO	Shefi i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Zagreb
4	4-6 Mars	Seancë e Komitetit Politik dhe Komitetit të Dimensionit Civil të Sigurisë të AP të NATO-s	Anëtar i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Athinë

⁵⁰ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

⁵¹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

5	14-15 Mars	Vizitë e delegacionit të Nënkomitetit për Tranzicion dhe Zhvillim dhe të Komitetit për Ekonomi dhe Siguri	Kryetari i Parlamentit, delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s dhe takime me institucione të tjera	Shkup
6	29-31 Mars	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm të AP të NATO-s	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të KE-së	Zagreb
7	4 Prill	Mbledhje e Parlamentit të Polonisë(Sejm) ku ratifikohej Protokoli për Anëtarësim i RMV-së në NATO	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Varshavë
8	12-14 Prill	Seminari “Ros-Rot” i AP të NATO-s	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Antali
9	30-31 Maj	Seminar i Qendrës për Studime Strategjike dhe të Sigurisë “Xhorxh Marshall”	Deputet të Parlamentit të RMV-së	Shkup
10	31 Maj- 3 Qershor	Sesioni pranveror i AP të NATO-s	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Bratisllavë
11	2- 3 Korrik	Vizitë e Sekretarit të NATO-s dhe delegacionit në përbërje prej 29 ambasadorë të vendeve anëtare të NATO-s -Para Parlamentit zyrtarisht u vendos flamuri i NATO-s	Kryetari i Parlamentit	Shkup
12	17 Korrik	Vizitë poligonit ushtarak Krivollak	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Krivollak
13	17-19 Shtator	Qendra për Studime të Sigurisë , Seminar për anëtarët e Komitetit Punues për Integrimin e RMV-së në NATO	Deputete- Anëtare nga Parlamenti i RMV-së në Komitetin Punues për Integrimin e RMV-së në NATO	Garmish Partenkirhen
14	11-14 Tetor	Sesioni vjetor i 65-të i AP të NATO-s	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Londër
15	4-7 Nëntor	Takime zyrtare në Francë të delegacionit të Dimensionit Civil të Mbrojtjes	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Paris Strazburg
16	9-11 Dhjetor	Sesioni i rregullt vjetor i 19-të, i Forumit Transatlantik të AP të NATO-s	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të NATO-s	Vashington

TABELA NR.16

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË UNIONIN INTER PARLAMENTAR (IUP) PËR VITIN 2019⁵²				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	4-6 Mars	Vizitë Dhomës së Ulët të Mbretërisë së Bashkuar, me ftesë nga grupi britanez i Unionit Interparlamentar.	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në UIP	Londër
2	6-10 Prill	Sesioni i 140-të parlamentar i UIP	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në UIP	Doha (Katar)
3	13-17 Tetor	Sesioni i 141-të parlamentar i UIP	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në UIP	Beograd

TABELA NR.17

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË DIMENSIONIN PARLAMENTAR TË INICIATIVËS SË EUROPËS QENDRORE (DP IEQ) PËR VITIN 2019⁵³				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	5 Shkurt	Takim me Sekretarin e DP IEQ	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së DP IEQ	Shkup
2	11 Nëntor	Sesioni i rregullt vjetor i DP IEQ	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në DP IEQ	Romë

TABELA NR.18

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË MESDHEUT (AP MESDHEUT) PËR VITIN 2019⁵⁴				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	25 Shkurt	Sesioni i 13 i AP të Mesdheut	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të Mesdheut	Beograd
2	19-21 Qershor	Konferencë e AP të Mesdheut	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Ankarë
3	2 Dhejtor	Konferencë e Komitetit Special Kundër Terorizmit të AP të Mesdheut	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të OSBE-së	Romë

⁵² www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

⁵³ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

⁵⁴ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

TABELA NR.19

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT NË EVROPËN JUGLINDORE (AP PBEJL) PËR VITIN 2019⁵⁵				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	22-23 Shkurt	Mbledhje e Komisionit për Zhvillim Social, Arsim dhe Shkencë të AP PBEJ	Anëtar i delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP PBEJ	Podgoricë
2	10-11 Maj	Mbledhje e Komisionit për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Siguri të AP PBEJ	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP PBEJ	Shkup
3	21-22 Qershor	Sesioni Plenar i 6-të i AP PBEJ	Anëtar i Delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP PBEJ	Sarajevë

TABELA NR.20

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË KOMITETIN PARLAMENTAR PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM PËR VITIN 2019⁵⁶				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	28 Mars	Mbledhja e 16-të e Komitetit të Përzier Parlamentar Maqedoni-BE	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim	Strazburg
2	17-19 Dhjetor	Mbledhja e 17-të e Komitetit të Përzier Parlamentar Maqedoni-BE	Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim	Strazburg

TABELA NR.21

AKTIVITETET E SEKSIONIT TË DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË FRANKOFONISË (AP FRANKOFONISË) PËR VITIN 2019⁵⁷				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	25 Mars	Konferencë e AP të Frankofonisë(Rajoni i Europës)	Anëtar i Seksionit të delegacionit të Parlamentit të RMV-së në AP të Frankofonisë	Bruksel

⁵⁵ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019


⁵⁶ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

⁵⁷ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

2	14-17 Prill	Konferencë e Seksioneve të Kryetarëve të Seksioneve të AP të Mesdheut-Regjioni i Europës	Kryetari i Seksionit të Delegacionit të RMV-së në AP të Frankofonisë	Athinë
3	14-15 Nëntor	Kuvendi Rajonal i Europës i seksioneve të AP të Frankofonisë	Delegacioni i Seksionit të Parlamentit të RMV-së në AP të Frankofonisë	Delemon(Z vicër)

Nga këto të dhëna, shihet se në vitin 2019, ka më shumë aktivitete multilaterale se sa në vitin paraprak. Një ndër arsyet kryesore për këtë shtim të aktiviteteve, ka të bëjë me ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës nga ana e Parlamentit të RMV-së. Ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës përfundoi me 11 Janar 2019, me votimin e 4 amandamenteve për ndryshimet Kushtetuese me çka, Republika e Maqedonisë u shëndrua në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë ndryshim të emrit, u hap rruga për anëtarësim të RMV-së në NATO. Me 6 shkurt nënshkruhet edhe protokoli paraqasës i NATO-s me RMV-në dhe në këtë periudhë, secili vend anëtar i NATO-s, fillon veçmas të ratifikojë protokollet për anëtarësim të RMV-së në NATO. Për këtë arsye vërehet se delegacioni që ka zhvilluar më shumë aktivitete multilaterale për vitin 2019, është pikërisht delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Delegacioni i Parlamentit të RMV-së në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në vitin 2019, ka zhvilluar 16 aktivitete. Aktivitetet e këtij delegacioni kishin të bëjnë me vizita studimore, mbledhje të Komitetit të AP të NATO-s me Këshillin Veri-Atlantik, vizitë parlamenteve të vendeve anëtare ku ratifikohej protokoli për anëtarësim të RMV-së në NATO dhe takime të tjera të ndryshme. Në vitin 2019, aktiv me aktivitete diplomatike, ka qenë edhe delegacioni i Parlamentit të RMV-së në AP të Këshillit të Europës, me gjithësej 10 aktivitete të zhvilluara në seanca të rregullta, konferenca dhe takime të tjera të ndryshme. Delegacionet e tjera për nga numri i aktiviteteve, janë pothuajse njësoj si në vitin 2018. Këto delegacione kanë zhvilluar nga 2, 3 ose 4 aktivitete multilaterale në vitin 2019. Gjithësej, në vitin 2019, delegacionet parlamentare të RMV-së kanë realizuar 44 aktivitete me karakter multilateral.

GRAFIKONI NR.6



5.1.6 AKTIVITETET BILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-së PËR VITIN 2019

Grupet për bashkëpunim bilateral të Parlamentit të RMV-së me Parlamentet e vendeve të tjera, janë të njëjtat si në vitin 2018. Parlamenti i RMV-së, në përbërjen 2017-2020, për bashkëpunim bilateral me parlamentet e vendeve të tjera, ka formuar 46 grupe. Këto grupe përbëhen nga 7 anëtarë. Në vijim, në mënyrë tabelare, do të prezentojmë aktivitetet që i zhvilluan këto grupe në vitin 2019.

TABELA 22

AKTIVITETET E GRUPEVE PARLAMENTARE PËR BASHKËPUNIM PËR VITIN 2019 ⁵⁸				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	23 Janar	Vizitë zyrtare e Kryetarit e Parlamentit të Malit të Zi, Takim	Grupi për bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Malin e Zi	Shkup


⁵⁸ www.sobranie.mk - "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

2	24 Janar	Takim me delegacionin e deputetëve të Parlamentit të Francës nga Grupi për Miqësi Francë-Maqedoni	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën	Shkup
3	11-12 Shkurt	Vizitë zyrtare në Slloveni. Takime me Presidentin, Kryeministrin, Kryetarin e Parlamentit, Komisione të Parlamentit dhe Grupit për Miqësi të Parlamentit Slloven me RMV-në	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Slloveninë	Lubllanë
4	26 Shkurt	Takim me Delegacionin nga Franca, i përbërë nga ministri për çështje evropiane dhe nga deputetë të Parlamentit të Francës	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Kryetari i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën	Shkup
5	13 Mars	Takim me Grupin për Bashkëpunim të Parlamentit të Rumanisë me RMV-në	Kryetari i Grupit për Bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së me Rumaninë	Bukuresht
6	21 Mars	Takim me nënkryetarin e Parlamentit të Polonisë	Nënkryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Poloninë	Shkup
7	2 Prill	Vizita zyrtare e parë e Kryeministrit të Greqisë në RMV, Takim	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe kryetari i Grupit për Bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së me Greqinë	Shkup
8	10 Prill	Vizitë e Zvç kryeministrit, njëherësh ministër i punëve të jashtme të Çekisë, Takim	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Çekinë dhe kryetari i Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri të Parlamentit të RMV-së	Shkup
9	17 Maj	Takim me delegacionin nga Parlamenti Danez	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Danimarkën	Shkup
10	13 Qershor	Takim me delegacionin nga Bundestagu gjerman	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Gjermaninë, Komisioni për Çështje Evropiane dhe Komisioni për Politikë të Jashtme	Shkup
11	15-20 Qershor	Vizitë zyrtare në Kinë	Kryetari i Parlamentit dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Kinën	Kinë
12	25 Korrik	Vizitë e delegacionit të grupit parlamentar nga Turqia (IYI Parti)	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe kryetari i Grupit për Bashkëpunim i	Shkup

			Parlamentit të RMV-së me Turqinë	
13	3 Tetor	Vizitë zyrtare e Presidentit të Malit të Zi, Takim	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Malin e Zi	Shkup
14	8-10 Tetor	Vizitë kthyesë në Parlamentin Francez	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën	Paris
15	29 Tetor	Takim me Odën Ekonomike Turke(MATTO)	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Turqinë	Shkup
16	1 Nëntor	Takim me Ambasadorin e Italisë në RMV	Kryetari i Grupit për Bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së me Italinë	Shkup
17	19 Nëntor	Takim me Kryetaren e Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Shqipërisë	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Shqipërinë	Shkup
18	3-4 Dhjetor	Vizitë zyrtare e delegacionit të Parlamentit të Rumanisë, Takim	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Rumaninë	Shkup
19	18 Dhjetor	Takim me delegacionin e deputetëve nga Kroacia	Kryetari i Grupit për Bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së me Kroacinë	Shkup
20	21 Dhjetor	Vizitë pune e Kryetarit të Parlamentit të Turqisë, Takim	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Turqinë	Shkup

Këto të dhëna tregojnë se aktivitetet e grupeve për bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së me Parlamentet e vendeve tjera, nuk dallojnë nga ato të vitit 2018. Nëse në vitin 2018 kishim 19 aktivitete të realizuara nga këto grupe, në vitin 2019 kemi një aktivitet më shumë, pra 20 aktivitete. Shumica e aktiviteteve janë zhvilluar në parlamentin e RMV-së, vetëm 4 janë zhvilluar në vende të tjera edhe atë, në Kinë, Francë, Slloveni dhe Rumani. Shumica e takimeve që u zhvilluan në Shkup, janë takime protokollare ose takime me ambasadorë të vendeve të huaja të akredituara në vendin tonë. Edhe pse këto grupe, për nga potenciali dhe nga aspekti formal, mund të zhvillojnë shumë aktivitete, në praktikë vërehet ngecje në këtë drejtim.

GRAFIKONI NR.7



5.1.7 AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE RMV-BE/PARLAMENTI EUROPIAN PËR VITIN 2019

Aktivitetet e Parlamentit të RMV-së me BE/Parlamentin Europian, janë aktivitete që i zhvillon Parlamenti i RMV-së me BE-në dhe me Parlamentin e BE-së. Këto aktivitete kanë të bëjnë me mbledhje, konferenca të ndryshme të cilat kanë për qëllim mbështetjen e vendit drejt integritimeve europiane, vizita të delegacioneve të ndryshme, seminare, tryeza dhe aktivitete të tjera.

TABELA NR.23


AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE- RMV- BE/PARLAMENTI EUROPIAN PËR VITIN 2019⁵⁹				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	29 Janar	Mbledhje e rregullt e sekretarëve të Parlamenteve të vendeve të BE-së dhe vendeve kandidate për në BE	Sekretari i Parlamentit të RMV-së	Vjenë

⁵⁹ www.sobranie.mk- "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

2	30 Janar	Konferencë e Programit të Parlamentit të BE-së për mbështetje të Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë	Delegacioni i deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Bruksel
3	17-20 Shkurt	Konferencë Interparlamentare	Delegacioni i deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Bruksel
4	1-2 Prill	Konferencë	Delegacioni i deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Bukuresht
5	17-27 Prill 4 Nëntor-13 Dhjetor	Programi për stazhistë në Parlamentin European	3 të punësuar në administratën e Parlamentit të RMV-së	Bruksel
6	13-14 Nëntor	Seminar Programi i Parlamentit të BE-së për mbështetje të Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë	Delegacioni i Deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Bruksel
7	3 Dhjetor	Tryezë për integrimin e Vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE	Delegacion i Deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Bruksel

Parlamenti i RMV-së, për vitin 2019, ka zhvilluar 7 aktivitete me BE-në dhe Parlamentin European. Për dallim nga viti 2018 ku janë zhvilluar 11 aktivitete, në vitin 2019 vërehet ulje e aktiviteteve, në vetëm 7 të tilla. Kryesisht, aktivitetet që janë zhvilluar në vitin 2019, kanë të bëjnë me mbledhjen e rregullt të sekretarëve të parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve kandidate për në BE, konferencë për mbështetje të parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, seminar, tryezë për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE etj.

GRAFIKONI NR.8



5.1.8 AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2019


Në vitin 2019, aktivitetet tjera ndërkombëtare të Parlamentit të RMV-së, kanë të bëjnë me pjesmarje në nisma të ndryshme rajonale, takime të kryetarëve të parlamenteve dhe aktivitete të tjera.

TABELA NR.24

AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2019 ⁶⁰				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	18-19 Mars	Konferencë e Kryetarëve të Parlamenteve të Iniciativës Adriatik-Jon	Kryetari i Parlamentit të RMV-së	Budva
2	23-24 Shtator	Takimi i 4-t, i Kryetarëve të Parlamenteve të Euro-Azisë	Kryetari i Parlamentit të RMV-së dhe një deputet i Parlamentit të RMV-së	Nur-Sulltan (Kazakistan)
3	29 Shtator	Forumi Parlamentar i Cetinjës	Delegacion i deputetëve të Parlamentit të RMV-së	Cetinje


Të dhënat për aktivitetet të ndryshme ndërkombëtare të parlamentit të RMV-së, tregojnë se në vitin 2019 janë zhvilluar 3 aktivitete. Në dy aktivitete ka marrë pjesë Kryetari i Parlamentit, në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të Iniciativës Adriatik-Jon dhe në takimin e 4-t të Kryetarëve të Parlamenteve të Euro-Azisë, kurse në Forumin Parlamentar të Cetinjës, ka marrë pjesë një delegacion i deputetëve nga Parlamenti i RMV-së.

GRAFIKONI NR.9



⁶⁰ www.sobranie.mk - "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019

GRAFIKONI NR.10



5.1.9 AKTIVITETET MULTILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-së PËR VITIN 2020

Viti 2020, dallon shumë nga dy vitet e mëparshme për të cilat kemi realizuar hulumtime, për disa arsye. Pandemia, mosfunksionimi i Parlamentit që nga shkurti deri në gusht, zgjedhjet parlamentare dhe përbërja e re parlamentare, janë disa nga arsyet kryesore që viti 2020 të jetë shumë më ndryshe nga vitet e tjera. Secila nga arsyet që përmendëm, ndikoi në mënyrën e vet në funksionimin dhe punën e Parlamentit. Pandemia nga COVID-19, përveç si problem dhe rrezik shëndetësor, u bë shkak që edhe Parlamenti fillimisht të jetë jofunksional për 6 muaj, por, edhe pasi filloi të funksionojë, tempon e funksionimit përsëri e diktonte Pandemia, duke ndikuar shumë në punën dhe aktivitetet e Parlamentit. Të dhënat e hulumtimit për vitin 2020, janë të dhëna pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, për periudhën nga 4 gusht e deri më 31 dhjetor. Pra, kemi të bëjmë me përbërje të re parlamentare. Zakonisht, në fillim të mandatit, çdo përbërje e re parlamentare formon edhe komisionet e punës, delegacionet, grupet e punës për

bashkëpunim etj. Për dallim nga përbërjet e tjera, këtë vit kemi disa ndryshime për nga numri i delegacioneve dhe grupeve për bashkëpunim që i formon Parlamenti.

Parlamenti i RMV-së për bashkëpunim multilateral, në mandatin 2020-2024, formoi 10 delegacione në këto organizata ndërkombëtare: Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (AP KE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë (AP OSBE), Asamblenë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (AP NATO), Unionin Interparlamentar (UIP), Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Europës Qendrore (DP IEQ), Asamblenë Parlamentare të Mesdheut (AP e Mesdheut), Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore (AP PBEJL) dhe Asamblenë Interparlamentare të Ortodoksisë, që është delegacion i ri i formuar për herë të parë gjatë këtij mandati. Të dhënat që do t'i praquesim nga hulumtimi i realizuar, kanë të bëjnë me aktivitetet e 9 delegacioneve, sepse për delegacioni e ri, nuk kemi ende të dhëna për aktivitetet e tij.

TABELA NR.25

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EUROPËS (AP KE) PËR PERIUDHËN 04.08. 2020-31.12. 2020⁶¹				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	12-13 Tetor 22-23 Tetor	Takim i Komitetit të Përhershëm, në përbërje të zgjeruar	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
2	27 Tetor	Konferencë rajonale parlamentare	Deputetë të Parlamentit të RMV-së	ONLINE
3	3 Nëntor	Konferencë rajonale ndërparlamentare	Deputetë të Parlamentit të RMV-së	ONLINE
4	20 Nëntor	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE

⁶¹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

TABELA NR.26

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË OSBE-SË (AP OSBE) PËR PERIUdhËN 04.08.2020-31.12.2020⁶²				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	4 Gusht	Mbledhje me temë për punën e Policisë	Ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
2	15 Tetor	Takim i Sekretarëve të Delegacionit	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
3	12 Nëntor	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm të AP të OSBE-së	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE

TABELA NR.27

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË UNIONIN INTER PARLAMENTAR (IUP) PËR PERIUdhËN 04.08.2020-31.12.2020⁶³				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	19-20 Gusht	Pjesa e parë e Konferencës Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
2	6 Tetor	Mbledhje e jashtëzakonshme e grupit gjeopolitik “12 plus”	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
3	15 Tetor	Takim i Sekretarëve të Delegacionit	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
4	19 Tetor	Mbledhje e jashtëzakonshme e grupit gjeopolitik “12 plus”	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
5	21 Tetor	Seancë dëgjimore të Kandidatëve për Kryetar të Unionit Interparlamentar	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
6	26 Tetor	Mbledhje e jashtëzakonshme e grupit gjeopolitik “12 plus”	Sekretari dhe ko-sekretari i Delegacionit	ONLINE
7	1-4 Nëntor	Sesioni i Këshillit Drejtues të	Kryetari i Parlamentit,	ONLINE

⁶² www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

⁶³ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

		Unionit Interparlamentar	anëtarë të Këshillit të Drejtues nga RMV , Sekretari dhe ko-sekretari i delegacionit	
--	--	--------------------------	--	--

TABELA NR.28

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË DIMENSIONIN PARLAMENTAR TË INICIATIVËS SË EVROPËS QENDRORE (DP IEQ) PËR PERIUdhËN 04.08.2020-31.12 2020⁶⁴				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
Për këtë periudhë, delegacioni nuk ka zhvilluar aktivitete				

TABELA NR.29

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-s (AP NATO) PËR PERIUdhËN 04.08.2020-31.12.2020⁶⁵				
N r.	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	31 Gusht	Mbledhje e Komitetit Politik	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
2	2 Shtator	Mbledhje e Komitetit për Mbrojtje dhe Siguri	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
3	9 Shtator	Mbledhje e Komitetit të Dimensionit Civil të Sigurisë	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
4	14 Shtator	Webinar për situatën në Bjello-Rusi	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
5	16 Shtator	Mbledhje e Komitetit për Ekonomi dhe Siguri	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
6	29 Shator	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
7	26 Gusht	Mbledhje e Sekretarëve të Delegacioneve	Sekretari i Delegacionit	ONLINE

⁶⁴ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

⁶⁵ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

8	28 Gusht	Mbledhje e Sekretarëve të Delegacioneve	Sekretari i Delegacionit	ONLINE
9	7 Tetor	Takim i grupës së ekspertëve të Sekretariatit Gjeneral të NATO-s për procesin NATO 2030, me Komitetin e Përhershëm të AP të NATO-s	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
10	15 Tetor	Webinar për Nagorno-Karabahun	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
11	26 Tetor	Webinar me zv.e Sekretarit Gjeneral të NATO-s, z. Mircea Geoana	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
12	29 Tetor	Webinar për sfidat dhe arritjet në implementimin e Agjendës së UNHCR për statusin e femrës, paqes dhe sigurisë	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
13	12 Nëntor	Webinar për hapat e ardhshme për integrimin Euro-Atlantik të Ballkanit Perëndimor	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
14	30 Nëntor	Seminari “Ros-Roth” për situatën Post-pandemike në Kaukazin Jugor	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
15	19-23 Nëntor	Sesioni vjetor i 66 i AP të NATO-s	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE (Athinë)
16	3 Dhjetor	Webinar për të ardhmen e kontrollit të armatimit	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
17	11 Dhjetor	Mbledhje e grupit special për Mesdheun dhe Lindjen e afërt	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE
18	15 Dhjetor	Webinar i Përbashkët AP NATO dhe DCAF(Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura)	Sekretariati i Delegacionit	ONLINE

TABELA NR.30

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË MESDHEUT (AP MESDHEUT) PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12.2020⁶⁶				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
Për këtë periudhë, delegacioni nuk ka zhvilluar aktivitete				

⁶⁶ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

TABELA NR. 31

AKTIVITETET E SEKSIONIT TË DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË FRANKOFONISË (AP FRANKOFONISË) PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12 2020⁶⁷				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
Për këtë periudhë, delegacioni nuk ka zhvilluar aktivitete				

TABELA NR.32

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT NË EUROPËN JUGLINDORE (AP PBEJL) PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12.2020⁶⁸				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	9 Dhjetor	Mbledhje e Komitetit të Përhershëm të AP PBEJL në kuadër të Kryesimit të R.Turqisë	Koordinatori dhe zv.koordinatori nacional	ONLINE

TABELA NR.33

AKTIVITETET E DELEGACIONIT TË PARLAMENTIT TË RMV-SË NË KOMITETIN PARLEMENTAR PËR STABILIZIM DHE ASOCHIM PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12 2020⁶⁹				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
Për këtë periudhë, komiteti nuk ka zhvilluar aktivitete				

⁶⁷ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

⁶⁸ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020


⁶⁹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

Nga të dhënat tabelare, shikohet më së miri ndikimi i Pandemisë-COVID-19 në aktivitetet e delegacioneve për bashkëpunim multilateral. Çdo aktivitet është mbajtur ONLINE dhe ajo që bie në sy, është se pjesëmarrës në këto aktivitete, janë sekretarët e delegacioneve e jo deputetët.

Deputetët kanë marrë pjesë vetëm në dy aktivitete që i ka zhvilluar AP e Këshillit të Evropës dhe në Sesionin e Këshillit Drejtues të Unionit Interparlamentar, ka marrë pjesë Kryetari i Parlamentit. Kjo tregon qartë se deputetët nuk ishin të përgaditur me sfidën e re, atë të diplomacisë digjitale - ONLINE. Prej Asambleve Parlamentare, më aktive me aktivitete gjatë kësaj periudhe ishte AP e NATO-s me 18 aktivitete ONLINE, pastaj Unioni Interparlamentar me 7 aktivitete, AP e Këshillit të Evropës me 4, AP e OSBE-së me 3 dhe me 1 aktivitet AP e Procesit të Bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore.

Dimensioni Parlamentar i Iniciativës së Europës Qendrore, AP e Mesdheut, AP e Frankfonisë dhe Komiteti për Stabilizimi dhe Asociim për vitin 2020 nuk kanë zhvilluar asnjë aktivitet.

GRAFIKONI NR.11



5.1.10 AKTIVITETET BILATERALE TË PARLAMENTIT TË RMV-së PËR VITIN 2020

Parlamenti i RMV-së, në përbërjen parlamentare 2020-2024, ka formuar 50 grupe parlamentare për bashkëpunim, 4 më shumë se sa grupet për bashkëpunim që ishin formuar në mandatin 2017-2020, edhe atë: Grupe parlamentare të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për bashkëpunim me Parlamentet e Republikës së Austrisë; Afganistanit; Azerbejxhanit; Australisë dhe Zelandës së Re; Shqipërisë, vendeve baltike; Belgjikës; Bosnjë e Hercegovinës; Bullgarisë; vendeve të Lindjes së Afërme dhe të Mesme; Gjermanisë; Greqisë; Danimarkës; Indisë; Indonezisë; Izraelit; Iranit; Irlandës; Islandës dhe Norvegjisë; Italisë; Japonisë; Kanadasë; Kazakistanit, Kirgistanit, Taxhikistanit, Uzbekistanit dhe Turkmenistanit; Kinës; Kosovës; vendeve të Amerikës Latine dhe të Karaibeve; Luksemburgut; Maltës dhe Qipros; Mongolisë; Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore; Polonisë; Portugalisë; Rumanisë; Rusisë; SHBA-së; Sllovakisë; Sllovenisë; Serbisë; Turqisë; Ukrainës; Hungarisë; Finlandës; Francës; Holandës; Kroacisë; Malit të Zi; Çekisë; Zvicrës; Suedisë dhe Spanjës.

Grupet e reja për bashkëpunim që janë formuar nga kjo përbërje parlamentare janë, grupi për bashkëpunim me parlamentin e Afganistanit; Azerbejxhanit, Indisë dhe grupi për bashkëpunim me Kazakistanin, Kirgistanin, Taxhikistanin, Uzbekistanin dhe Turkmenistanin. Grupet parlamentare për bashkëpunim, përbëhen nga 7 anëtarë.

TABELA NR.34


AKTIVITETET E GRUPEVE PARLAMENTARE PËR BASHKËPUNIM PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12.2020⁷⁰				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	17 Nëntor	Takim me delegacionin e Parlamentit të Suedisë	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Suedinë	ONLINE
2	7 Dhjetor	Takim me delegacionin e Parlamentit të Suedisë në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim të demokracisë	Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Suedinë	ONLINE
3	7 Dhjetor	25 vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Izraelin. Takim me	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Izraelin	ONLINE

⁷⁰ www.sobranie.mk- "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

		delegacionin e Grupit të Miqësisë së Parlamentit të Izraelit me RMV-në. Në takim merrnin pjesë edhe ambasadorët e të dyja vendeve		
4	15 Dhjetor	Takim me Ambasadorin e Francës në RMV	Grupi për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Francën	Parlamenti i RMV-së, Shkup
5	21 Dhjetor	Vizitë zyrtare e Kryetarit të Parlamentit të R. Turqisë. Takim	Kryetari i Parlamentit dhe kryetari i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Turqinë	Shkup
6	27 Dhjetor	Takim me Kryetarin e Grupit të Miqësisë së Parlamentit të Britanisë Madhe me RMV-në	Kryetari i Grupit për Bashkëpunim i Parlamentit të RMV-së me Britaninë e Madhe	ONLINE

Grupet Parlamentare për bashkëpunim, gjatë periudhës 31 gusht - 31 dhjetor të vitit 2020, kanë zhvilluar 6 aktivitete, nga të cilat, 4 aktivitete janë zhvilluar ONLINE dhe 2 të tjera në Shkup. Njëri takim ishte vizita zyrtare e Kryetarit të Parlamentit të Turqisë në RMV dhe takimi tjetër ishte takimi që ka realizuar grupi për miqësi me Francën, me ambasadorin e R. së Francës në RMV. Këto takime janë zhvilluar në Parlamentin e RMV-së. Nga të dhënat, vërejmë se Pandemia ka ndikuar edhe në aktivitetet bilaterale të Parlamentit të RMV-së.

GRAFIKONI NR.12



5.1.11 AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE RMV-BE/ PARLAMENTI EVROPIAN PËR VITIN 2020

Aktivitetet mes Parlamentit të RMV-së dhe BE-së, kryesisht kanë të bëjnë me aktivitete që organizon Parlamenti Evropian për t'i ndihmuar parlamentet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt euro-integrimeve.

TABELA NR.35

AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE- RMV- BEçPARLAMENTI EUROPIAN PËR PERIU DHËN 04.08.2020-31.12.2020⁷¹				
Nr	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
1	3 Nëntor	Takim virtual me treshen e angazhuar për mbajtjen e dialogut “Zhan Mone”	Kryetari i Parlamentit të RMV-së, koordinorët e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e partive parlamentare që nuk kanë grup parlamentar	ONLINE

Nga të dhënat kuptojmë se është mbajtur vetëm një aktivitet ONLINE në lidhje me dialogun politik që zhvillohet në RMV, e që përkrahet nga BE-ja. Bëhet fjalë për dialogun “Zhan Mone”. Në këtë takim virtual, kanë marrë pjesë Kryetari i Parlamentit bashkë me koordinorët e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e partive të tjera parlamentare që nuk kanë grupe parlamentare, si dhe përfaqësuesit e BE-së të angazhuar në këtë dialog.

⁷¹ www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020


5.1.12 AKTIVITETE TJERA NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2020

TABELA NR.36

AKTIVITETE TË TJERA NDËRKOMBËTARE PËR PERIUDHËN 04.08.2020-31.12 2020 ⁷²				
N r	Data	Lloji i Aktivitetit	Niveli i Përfaqësimit	Vendi
Për këtë periudhë, delegacioni nuk ka zhvilluar aktivitete				


Parlamenti i RMV-së për vitin 2020 nuk ka realizuar aktivitete të tjera ndërkombëtare. Mungesë e aktiviteteve, kryesisht ka të bëjë me situatën e Pandemisë dhe me zgjedhjet e mbajtura parlamentare. Parlamenti i RMV-së, duke qenë shumë i zënë me problemet e brendëshme, nuk gjeti mënyrë përshtatjeje në rrethanat e reja të krijuara, sidomos të jetë më aktiv në diplomacinë digjitale-ONLINE.

GRAFIKONI NR.13



⁷² www.sobranie.mk- "Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së" për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020

DIAGRAMI NR.1



KAPITULLI -VI-

6. SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI I REALIZUAR

Për këtë punim janë realizuar intervista me deputetë aktualë, deputetë të përbërjeve të kaluara parlamentare dhe me të punësuar në Sektorin për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Parlamentin e RMV-së, me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë të merret vlerësimi dhe mendimi i tyre, për kapacitetet diplomatike të Parlamentit si dhe njëkohësisht të njohim edhe përvojat e tyre si anëtarë të delegacioneve ose grupeve për bashkëpunim të Parlamentit të RMV-së. Në vijim do të shpalosim rezultatet nga intervistat e realizuara.

6.1 INTERVISTAT

Intervistë me Dr. Gazmend Aliji

1. Cili është roli i Parlamentit të RMV-së në diplomaci?

-Roli i parlamentit të RMV-së në diplomaci, është i përcaktuar edhe me ligj, kjo do të thotë se roli i Kuvendit, është i pazëvendësueshëm. Parlamenti është institucioni që formon Grupe për Bashkëpunim me të gjithë parlamentet e shteteve me të cilat RMV ka marrëdhënie diplomatike. Këto Grupe për Bashkëpunim, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik, politik, kulturor, arsimor dhe të shumë sferave të tjera të raporteve mes shteteve.

2. A mendoni se Parlamenti i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare?

-Parlamenti mendoj se ka kapacitete të mjaftueshme për aktivitete diplomatike. Kuvendi e ka edhe si obligim që komisionet ose Grupet për Bashkëpunim, të marrin pjesë në takimet e organizatave të ndryshme, siç janë Grupi për Bashkëpunim me Unionin European (Komiteti i përzier parlamentar RMV-BE), ai për Këshillin European, në NATO, në OSBE, edhe grupet për bashkëpunim me shumë organizata dhe asociacione të tjera në interes të shtetit. Por këtu nuk duhet të harrojmë edhe pjesëmarrjen e tyre në punimet edhe të shumë organizatave të tjera joqeveritare me karakter humanitar. Të gjitha këto komisione dhe grupe të deputetëve, zgjidhen në Parlamentin e RMV-së.

3.Si është bashkëpunimi me diplomacinë zyrtare e cila udhëhiqet nga MPJ?

-Parlamenti dhe MPJ, duhet të kenë qëndrime të harmonizuara, për shkak të interesave shtetërore , por te ne, shumë herë, shumica parlamentare, për shkak të interesave partiake, di që edhe në politikën e jashtme, më tepër t'i zbatojë agjendat e tyre partiake, me ushtarë partiakë e jo me diplomatë të dëshmuar. Prandaj, lirisht mund të themi, se bashkpunim ka, por jo sa duhet.

4. Deputetët gjatë aktiviteteve diplomatike, a kanë qëndrime të unifikuara si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale?

-Shumë herë mund të themi se deputetët, më tepër punojnë për interesat partiake, se sa për ato shtetërore. Prandaj shumë herë nuk kanë qëndrime të unifikuara.

5. Sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare?

-Deputetët, në shumicën e rasteve, tregojnë interesim për kyçjen e tyre aktive me diskutime dhe propozime të ndryshme, por zakonisht, propozimet, sidomos të deputetëve të opozitës, që janë më të mira e plot me ide kreative, përfundojnë aty ku kanë filluar, sepse pozita imponon vetëm idetë e veta, edhe pse të njëjtat nuk janë as të mira, as të realta. Por si zakonisht në vendin tonë, pozita imponon vetëm agjendën e saj.

6. A mendoni se janë të mjaftueshme aktivitetet e Grupeve Parlamentare për Bashkëpunim(Grupeve të Miqësisë), me Parlamentet e vendeve të tjera?

-Aktivitetet e Grupeve të deputetëve për Miqësi, nuk janë të mjaftueshme, por besoni se edhe ata takime që mbahen, nuk janë të përkrahura sa duhet nga udhëheqësia e Parlamentit, me arsyetim se krijojnë shumë shpenzime. Edhe pse puna e këtyre grupeve është e pazëvendësueshme, prapë se prapë, për mbarëvajtjen e saj, krijohen probleme të panevojshme.

7. Si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19?

- Është e vërtetë që pandemia arriti që të ngadalsojë aktivitetet diplomatike në nivel botëror, e njëjta ndodhi edhe me diplomacinë e vendit tonë. Vendi ynë, shume kohë mbeti pa përfaqësi në vendet me ndikim në politikën ndërkombëtare, kështu që pasojat i shohim çdo ditë te ne dhe në mbarë botën. Unë mendoj që bota pas kësaj pandemie, sigurisht më nuk do të jetë e njëjta, kurrë më nuk do të jetë si ka qenë. Kjo padyshim duhet të shoqërohet edhe me mënyrën se si një vend zhvillon diplomacinë e cila gjithashtu, qartë do të ndryshojë.

8. A është e përgaditur RMV si shtet për diplomaci digjitale dhe çfarë mendoni se duhet ndryshuar në këtë drejtim në të ardhmen?

-Në qoftë se qëndron teza se bota më nuk do të jetë si më parë, e ndryshimi rrënjësor ka nisur që në fillim të vitit 2020, atëherë mendoj se edhe Maqedonia e Veriut, do të duhet të ndryshojë shumë gjëra, e më kryesorja e që duhet bërë shpejt, është që të digjitalizohet si e tërë bota, nëse do të hecë në hap me kohën.

Intervistë me Meral Uzeir-Ferati

1. Cili është roli i Parlamentit të RMV-së në diplomaci?

-Parlamenti aktivitetin e tij e bazon në Kushtetutën, Ligjin për Parlamentin dhe në Rregulloren e Parlamentit. Parlamenti, si institucioni më i lartë në vend, përveç se ushtron Pushtetin Legjislativ, si mbykëqyrës e “kontrollues” i Pushtetit Ekzekutiv, luan rol të rëndësishëm edhe në politikën e jashtme të vendit e sidomos luan rol të rëndësishëm në diplomaci. Parlamenti ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare, miraton rezoluta, formon delegacione për bashkëpunim multilateral dhe grupe për bashkëpunim bilateral.

2. A mendoni se Parlamenti i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare?

- Parlamenti i RMV-së, në aspektin formal, administrativë dhe teknik, i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit të kapaciteteve, vërehet se shpeshherë mungon vullneti politik, angazhimi i dobët i deputetëve dhe mungesa financiare.

3. Si është bashkëpunimi me diplomacinë zyrtare e cila udhëhiqet nga MPJ?

- Bashkëpunimi i Parlamentit me MPJ-në është në nivelin e duhur profesional. Ajo që vërehet, sidomos gjatë takimeve ose konferencave multilaterale që organizohen nëpër vendet e ndryshme të rajonit ose botës, është mungesa e stafit të mjaftueshëm nëpër përfaqësitë diplomatike-konzullore të RMV-së.

4. Deputetët gjatë aktiviteteve diplomatike, a kanë qëndrime të unifikuara si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale?

- Sa i përket çështjeve strategjike, që kanë të bëjnë me integrimet euro-atlantike të vendit pothuajse në të gjitha rastet deputetët kanë qëndrime të unifikuara që përkrahin këto procese, kurse për çështje tjera vërehen dallimet e deputetëve, ku më së shumti shprehen qëndrimet dhe bindjet e vijës së partisë që përfaqësojnë.

5. Sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare?

- Janë të paktë ata deputetë që shquhen me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare. Shumica, fatkeqësisht, janë jo aktiv dhe mjaftohen vetëm me pjesëmarrje pasive në konferencat ose takimet e ndryshme, qoftë të karakterit multilateral ose bilateral.

6. A mendoni se janë të mjaftueshme aktivitetet e Grupeve Parlamentare për Bashkëpunim(Grupeve të Miqësisë), me Parlamentet e vendeve të tjera?

- Grupet Parlamentare të Miqësisë janë të mjaftueshme. Ka mbi 50 grupe të tilla për bashkëpunim, që përfshijnë shumicën e vendeve të botës. Sa i përket aktiviteteve të këtyre grupeve, vërehet mungesa e plotë e aktiviteteve. Mungojnë iniciativat dhe aktivitetet për

bashkëpunim. Këto grupe janë një mundësi shumë e mirë që RMV të zë miq të shumtë në arenën ndërkombëtare, por kjo gjë fatkeqsisht nuk ndodh, sepse nuk ka interesim dhe mungojnë aktivitetet në këtë drejtim.

7. Si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19?

-Pandemia nga Covid 19, ashtu siç ndikoi në të gjitha sferat e jetës së shoqërisë dhe në mënyrën e funksionimit të institucioneve të shtetit, gjithsesi ka ndikuar shumë edhe në diplomaci, duke e penguar të zhvillohet si më parë, me takime të drejtpërdrejta, organizimet e konferencave të ndryshme me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë e kështu me rradhë. Në anën tjetër, Pandemia zhvilloi një lloj tjetër të diplomacisë, atë të ONLINE-Diplomacisë, e mendoj se kjo formë e diplomacisë do të zhvillohet edhe më shumë edhe në të ardhmen.

8. A është e përgaditur RMV si shtet për diplomaci digjitale dhe çfarë mendoni se duhet ndryshuar në këtë drejtim në të ardhmen?

-RMV, si për çdo gjë tjetër që s'është e përgaditur, nuk është e përgaditur edhe për diplomacinë digjitale. Për t'u ndryshuar kjo gjë dhe për të qenë të përgaditur për sfidat e së ardhmes, në RMV duhet ndryshuar shumë gjëra, duke filluar nga ndryshimi i mendësisë partizane në favor të profesionalizimit, të kuptuarit se diplomacia të ndihmon shumë në vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe krijimit të miqësive të reja dhe se të jesh deputet do të thotë se je aty për t'i përfaqësuar qytetarët e jo vetveten ose interesat personale.

Intervistë me Ane Llashkovska

1. Cili është roli i Parlamentit të RMV-së në diplomaci?

- Me keqardhje mund të konstatoj se Parlamenti nuk ka asnjë rol në Diplomacinë Parlamentare.

2. A mendoni se Parlamenti ka kapacitete të duhura për aktivitete ndërkombëtare?

-Parlamenti i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare, por për keqardhje është se këto kapacitete nuk shfrytëzohen, ose dikush nuk lejon që të shfrytëzohen këto kapacitete për aktivitete ndërkombëtare.

3. Si është bashkëpunimi me diplomacinë zyrtare e cila udhëhiqet nga MPJ?

- Bashkëpunimi me MPJ është i keq. Praktikisht nuk ka bashkëpunim në sferën e diplomacisë.

4. Gjatë aktiviteteve diplomatike, a kanë qëndrime të unifikuara deputetët si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale?

- Gjatë aktiviteteve diplomatike, deputetët nuk kanë qëndrime të unifikuara.

5. Sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare?

- Për sa i përket aktiviteteve të deputetëve në takimet ndërkombëtare, janë shumë të pakta, pothuajse nuk ekzistojnë.

6. A mendoni se janë të mjaftueshme aktivitetet e Grupeve Parlamentare për Bashkëpunim (Grupeve të Miqësisë), me Parlamentet e vendeve të tjera?

- Aktivitetet e Grupeve të Miqësisë me Parlamentet e vendeve tjera nuk janë të mjaftueshme.

7. Si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19?

- Pandemia ndikoi negativisht edhe në Diplomacinë Parlamentare. Marrë parasysh ndikimin e pushtetit ekzekutiv që ka ndaj parlamentit dhe sjelljes injoruese të qeverisë ndaj Parlamentit, nuk pres se do ndryshojë ndonjë gjë edhe në të ardhmen.

8. A është e përgaditur RMV si shtet për diplomaci digjitale dhe çfarë mendoni se duhet ndryshuar në këtë drejtim në të ardhmen?

- Mendoj se nëse ka vullnet të mire dhe përkushtim, mund të kemi sukses në diplomacinë digjitale.

Intervistë me Pançe Minov

1. Cili është roli i Parlamentit të RMV-së në diplomaci?

- Parlamenti i RMV-së ka rol shumë aktiv në Diplomacinë Parlamentare. Në Parlamentin e RMV-së formohen delegacione dhe grupe parlamentare për bashkëpunim me parlamentet tjera në botë. Në të njëjtit, anëtarë janë deputetët e mandatuar nga parti të ndryshme politike, që në mënyrë aktive marrin pjesë në punën e këtyre grupeve dhe delegacioneve. Për përgaditjen e aktiviteteve diplomatike kujdeset Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Parlamentit të RMV-së.

2. A mendoni se Parlamenti ka kapacitete të duhura për aktivitete ndërkombëtare?

- Po, Parlamenti i RMV-së ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare dhe është i hapur për këto lloj aktivitete.

3. Si është bashkëpunimi me diplomacinë zyrtare e cila udhëhiqet nga MPJ?

- Parlamenti i RMV-së ka bashkëpunim aktiv me MPJ-në e RMV-së. Në vizitat apo pjesëmarrjen tonë në takime pune jashtë RMV-së, ambasadat dhe konsullatat tona gjithmonë i shoqërojnë deputetët dhe ndihmojnë në përgaditjen e delegacioneve të parlamentit në domen të aspektit ndërkombëtar. Në Parlament mbajmë kontakte aktive me MPJ-në gjatë takimeve që i zhvillojmë me grupet e ndryshme për bashkëpunim me parlamentet e vendeve të ndryshme, me ambasadorë, vizitave zyrtare. MPJ i ndihmon Parlamentit të RMV-së me materiale e mendime dhe anasjelltas.

4. Gjatë aktiviteteve diplomatike, a kanë qëndrime të unifikuara deputetët si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale?

- Zakonisht po, deputetët kanë qëndrime të unifikuara në aktivitetet ndërkombëtare. Gjatë pjesëmarrjes së tyre në takime të ndryshme ndërkombëtare, të Asambleve parlamentare, konferencave të ndryshme dhe aktivitete tjera më me rëndësi është interesi i shtetit, pa dallim nga përfaqësimi politik dhe etnik.

5. Sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare?

-Për shkak Pandemisë nga COVID-19, deputetët marrin pjesë në konferenca dhe takime virtuale. Ka mjaft video-konferenca dhe mjaft interes për të njëjtat. Sa të mundësoj situata, takimet do të vazhdojnë si më parë me prezence fizike. Edhe përkundër situatës me Pandeminë, deputetët fuqishëm angazhohen për realizimin e marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore dhe për politikë rajonale miqësore, si dhe angazhohen për kapërcimin e të gjitha çështjeve të hapura që mund të paraqesin pengesë për integrimin e plotë të vendit tone në Unionin European.

6. A mendoni se janë të mjaftueshme aktivitetet e Grupeve Parlamentare për Bashkëpunim(Grupeve të Miqësisë), me Parlamentet e vendeve të tjera?

-Shumica e grupeve parlamentare për bashkëpunim janë aktiv dhe këto grupe janë të mjaftueshme. Çdo grup për bashkëpunim ka kryetarin e grupit dhe anëtarët. Kryetari i grupit, është shefi i delegacionit gjatë aktiviteteve jashtë shtetit.

7.Si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19?

- Parlamenti i RMV-së, gjatë Pandemisë ka zhvilluar aktivitete me prezencë fizike. Është punuar me rotacion në përputhje me protokollet mjekësore. Takimet më së shumti janë mbajtur në mënyrë virtuale, kurse seancat plenare të Parlamentit janë mbajtur me prezencë fizike. Diplomacia Parlamentare tani për tani nuk pati pengesa të mëdha nga Pandemia.(Spjeguar më lart).

8. A është e përgaditur RMV si shtet për diplomaci digjitale dhe çfarë mendoni se duhet ndryshuar në këtë drejtim në të ardhmen?

-RMV deri diku është e përgaditur për diplomaci digjitale, por ka mjaft punë rreth aspektit teknik. Rreth kësaj duhet ende të sofistikohet.

Intervistë me Dr. Liman Avdiu

1. Cili është roli i Parlamentit të RMV-së në diplomaci?

-Parlamenti i RMV-së përveç se miraton dhe sjellë rezoluta, formon edhe delegacione dhe grupe për bashkëpunim me parlamentet e vendeve të tjera të botës. Parlamenti i RMV-së ka rol të rëndësishëm në politikën e jashtme të vendit dhe në diplomaci.

2. A mendoni se Parlamenti i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare?

-Po, Parlamenti ka kapacitete të nevojshme për t'i kryer me sukses obligimet. Gati të gjithë nëpunësit e Parlamentit, përveç që zotërojnë bukur gjuhët e huaja (anglisht, frëngjisht edhe gjermanisht disa prej tyre), ata kanë kryer trajnime, specializime, studime master dhe studime doktorale në institucionet e njohura ndërkombëtare, si dhe në parlamentet e shteteve të BE-së, SHBA-së, Britaninë e Madhe etj. Sa i përket deputetëve, nga përvoja mund të them se jo përherë deputetët si anëtarë të delegacioneve për bashkëpunim ndërkombëtar, i kanë përgatitjet e duhura, sidomos njohjen e gjuhëve të huaja dhe përgatitje të tjera (njohuri protokollare për evente ndërkombëtare...).

3. Si është bashkëpunimi me diplomacinë zyrtare e cila udhëhiqet nga MPJ?

- Bashkëpunim profesional në nivel.

4. Deputetët gjatë aktiviteteve diplomatike, a kanë qëndrime të unifikuara si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale?

-Shumë rrallë ndodh që anëtarët e Delegacionit të Kuvendit të RMV në një Asamble Parlamentare Ndërkombëtare, të kenë qëndrime dhe pozicione të ndryshme nga pozicioni zyrtar i shtetit.

5. Sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare?

-Ka deputetë që janë shumë aktiv, e të tjerë shumë pak e aspak.

6. A mendoni se janë të mjaftueshme aktivitetet e Grupeve Parlamentare për Bashkëpunim(Grupeve të Miqësisë), me Parlamentet e vendeve të tjera?

-Po, mjafton numri i tyre . Për shtetet për të cilat nuk ka pasur grupe të tilla, me kërkesë qoftë të shtetit të huaj apo të deputeteve, janë formuar edhe grupe shitesë.

7. Si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19?

- Pandemia (Covid-19) ka ndikuar shumë në aktivitetet ndërkombëtare dhe diplomatike të Parlamentit, sepse ka pamundësuar mbajtjen e seancave, konferencave, mbledhjeve, takimeve me prezencë fizike dhe këto janë mbajtur me Webinar (Videokonferenca online) dhe njohuritë jo të mjaftueshme IT të disa deputetëve, kanë qenë pengesë për realizimin e këtyre aktiviteteve.

8. A është e përgaditur RMV si shtet për diplomaci digjitale dhe çfarë mendoni se duhet ndryshuar në këtë drejtim në të ardhmen?

-RMV është shumë pak e përgaditur për diplomaci digjitale. Duhet ndryshuar shumë gjëra që vendi të jetë gati për sfidat e së ardhmes, e kjo nënkupton trajnime, staf profesional të përgaditur dhe përfaqësues që njohin dhe kuptojnë rëndësinë e rolit të diplomacisë.

Nga intervistat mund të nxjerrim këto përfundime. Për sa i përket kornizës formale të rolit të Parlamentit në Diplomaci, shumica e subjekteve të intervestuara, në përgjigjet e tyre, pajtohen se Parlamenti luan rol të rëndësishëm në diplomaci. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit të kapaciteteve dhe për aktivitetet diplomatike të Parlamentit, në përgjigjet e subjekteve vihen re dallimet që kanë të bëjnë me proviniencën politike, etnike dhe profesionale.

1. Pyetjes së parë të gjithë subjektet e intervestuar kanë dhënë të njëjtin përkufizim sa i përket rolit të Parlamentit të RMV-së në diplomaci, përveç Ane Lashkovskës që dallon dhe veçohet në përkufizimin e rolit të Parlamentit në diplomaci. Ane Lashkovska për rolin e Parlamentit të RMV-së në diplomaci thotë: **“Me keqardhje mund të konstatoj se Parlamenti nuk ka asnjë rol në Diplomacinë Parlamentare”**. Ndryshe nga Ane Lashkovska, mendon ish deputetja Meral Ferati, e cila është përgjigjur kështu: **“Parlamenti aktivitetin e tij e bazon në Kushtetutën, Ligjin për Parlamentin dhe në Rregulloren e Parlamentit. Parlamenti, si institucioni më i lartë në vend, përveç se ushtron Pushtetin Legjislativ, si mbykëqyrës e “kontrollues” i Pushtetit Ekzekutiv, luan rol të rëndësishëm edhe në politikën e jashtme të vendit e sidomos luan rol të rëndësishëm në diplomaci. Parlamenti ratifikon marrëveshjet**

ndërkombëtare, miraton rezoluta, formon delegacione për bashkëpunim multilateral dhe grupe për bashkëpunim bilateral.” Për afërsisht si Meral Ferati përgjigjet edhe Pançe Minov, ku thotë se; **“Parlamenti i RMV-së ka rol shumë aktiv në Diplomacinë Parlamentare. Në Parlamentin e RMV-së formohen delegacione dhe grupe parlamentare për bashkëpunim me parlamentet tjera në botë. Në të njëjtë, anëtarë janë deputetët e mandatuar nga parti të ndryshme politike, që në mënyrë aktive marrin pjesë në punën e këtyre grupeve dhe delegacioneve. Për përgaditjen e aktiviteteve diplomatike kujdeset Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Parlamentit të RMV-së.”**

Pra mund të konstatojmë se Kushtetuta, Ligjet dhe Rregullorja, i mundësojnë Parlamentit republikan të ketë një rol mjaft të rëndësishëm në diplomacinë parlamentare, por shfrytëzimi në maksimum i këtij roli, varet nga vullneti i deputetëve dhe drejtuesve të Parlamentit.

2. Në pyetjen e dytë që kishte të bëjë me kapacitetet e Parlamentit të RMV-së për aktivitetet ndërkombëtare, të gjithë subjektet e intervistuar pajtohen njëzëri se Parlamenti i RMV-së në aspektin formal dhe teknik i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare. Dallimet në përgjigje kanë të bëjnë me shfrytëzimin dhe përdorimin e këtyre kapaciteteve. Meral Uzeir Ferati thotë: **“Parlamenti i RMV-së, në aspektin formal, administrativë dhe teknik, i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit të kapaciteteve, vërehet se shpeshherë mungon vullneti politik, angazhimi i dobët i deputetëve dhe mungesa financiare”.** Ndërsa Ana Llashkovska kësaj pyetje i është përgjigjur kështu: **“Parlamenti i ka kapacitetet e duhura për aktivitete ndërkombëtare, por për keqardhje është se këto kapacitete nuk shfrytëzohen, ose dikush nuk lejon që të shfrytëzohen këto kapacitete për aktivitete ndërkombëtare”.** Pançe Minov mendon se; **“Po, Parlamenti i RMV-së ka kapacitetet e duhura për aktivitet ndërkombëtare dhe është i hapur për këto lloj aktivitete”** dhe për dallim nga të tjerët nuk paraqet ndonjë vërejtje apo pengesë rreth aktiviteteve ndërkombëtare të Parlamentit. Në pyetjen e dytë veçohet përgjigja e Liman Avdiut që bën dallim mes kapaciteteve diplomatike të nëpunësve të Parlamentit dhe të deputetëve. Në këtë pyetje Liman Avdiu përgjigjet kështu: **“Po, Parlamenti ka kapacitete të nevojshme për t'i kryer me sukses obligimet. Gati të gjithë nëpunësit e Parlamentit, përveç që zotërojnë bukur gjuhët e huaja (anglisht, frëngjisht edhe gjermanisht disa prej tyre), ata kanë kryer**

trajtime, specializime , studime master dhe studime doktorale në institucionet e njohura ndërkombëtare, si dhe në parlamentet e shteteve të BE-së, SHBA-së, Britaninë e Madhe etj. Sa i përket deputetëve, nga përvoja mund të them se jo përherë deputetët si anëtarë të delegacioneve për bashkëpunim ndërkombëtar, i kanë përgatitjet e duhura, sidomos njohjen e gjuhëve të huaja dhe përgatitje të tjera (njohuri protokollare për evente ndërkombëtare...).”

Pra mund të konstatojmë se Parlamenti i RMV-së, i ka kapacitetet e mjaftueshme e të domosdoshme për të zhvilluar maksimalisht Diplomacinë parlamentare sa i përket administratës kuvendore, por vërehet mungesë vullneti politik që kjo lloj diplomacie të zhvillohet në maksimumet e saj.

3. Për bashkëpunimin e Parlamentit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, kemi përgjigje të ndryshme nga subjektet e intervistuar. Përderisa njëri lëvdëron bashkëpunimin, të tjerët thonë se bashkëpunim ka, por jo sa duhet, ose edhe se bashkëpunimi fare nuk ekziston. Për bashkëpunimin mes Parlamentit dhe MPJ-së, ish deputeti Gazmend Aliji thotë kështu: **“Parlamenti dhe MPJ, duhet të kenë qëndrime të harmonizuara, për shkak të interesave shtetërore , por te ne, shumë herë, shumica parlamentare, për shkak të interesave partiake, di që edhe në politikën e jashtme, më tepër t’i zbatojë agjendat e tyre partiake, me ushtarë partiakë e jo me diplomatë të dëshmuar. Prandaj, lirisht mund të themi, se bashkëpunim ka, por jo sa duhet”**. Ana Llashkovska shkon edhe më larg duke thënë se: **“Bashkëpunimi me MPJ është i keq. Praktikisht nuk ka bashkëpunim në sferën e diplomacisë”**. Në anën tjetër Pançe Minov dallon prej të tjerëve në përgjigjen e kësaj pyetje duke lavdëruar bashkëpunimin e Parlamentit me MPJ-në duke nënvizuar se : **“Parlamenti i RMV-së ka bashkëpunim aktiv me MPJ-në e RMV-së. Në vizitat apo pjesëmarrjen tonë në takime pune jashtë RMV-së, ambasadat dhe konsullatat tona gjithmonë i shoqërojnë deputetët dhe ndihmojnë në përgaditjen e delegacioneve të parlamentit në domen të aspektit ndërkombëtar. Në Parlament mbajmë kontakte aktive me MPJ-në gjatë takimeve që i zhvillojmë me grupet e ndryshme për bashkëpunim me parlamentet e vendeve të ndryshme, me ambasadorë, vizitave zyrtare. MPJ i ndihmon Parlamentit të RMV-së me**

materiale e mendime dhe anasjelltas". Liman Avdiu thotë se : **"Bashkëpunimi është në nivel"**.

Nga kjo mund të konstatojmë se deputetët, sidomos ata që vijnë nga radhët e partive opozitare, ndjejnë se anashkalohen nga MPJ kur bëhet fjalë për vendime të politikës së jashtme, se deputetët shihen thjesht si makineri votimi për ligjet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme, ndërkohë që për çështje diplomatike kryesisht vendos shumica qeverisëse.

4. Rreth pyetjes nëse gjatë aktiviteteve diplomatike, deputetët kanë ose jo qëndrime të unifikuara si grup që përfaqëson shtetin, apo kanë qëndrime të ndara, secili në bazë të bindjeve të tyre partiake ose individuale, subjektet e intervistuar kanë dhënë përgjigje të larmishme. Për Liman Avdiun **"shumë rrallë ndodh që anëtarët e Delegacionit të Kuvendit të RMV në një Asamble Parlamentare Ndërkombëtare, të kenë qëndrime dhe pozicione të ndryshme nga pozicioni zyrtar i Shtetit"**. Meral Ferati mendon që për **"çështjet strategjike, që kanë të bëjnë me integritet euro-atlantike të vendit pothuajse në të gjitha rastet deputetët kanë qëndrime të unifikuara që përkrahin këto procese, kurse për çështje tjera vërehen dallimet e deputetëve, ku më së shumti shprehen qëndrimet dhe bindjet e vijës së partisë që përfaqësojnë"**. Pançe Minov në anën tjetër mendon se **"zakonisht po, deputetët kanë qëndrime të unifikuara në aktivitetet ndërkombëtare. Gjatë pjesëmarrjes së tyre në takime të ndryshme ndërkombëtare, të Asambleve parlamentare, konferencave të ndryshme dhe aktivitete tjera më me rëndësi është interesi i shtetit, pa dallim nga përfaqësimi politik dhe etnik"**, kurse krejtësisht tjetër gjë për këtë mendon Ana Llashkovska ku thotë se **"gjatë aktiviteteve diplomatike, deputetët nuk kanë qëndrime të unifikuara"**.

Edhe këtu mund të konstatojmë se provinienca politike e deputetëve, sigurisht që ndikon edhe në vendimet që merren nga Kuvendi. Ka sigurisht unifikim qëndrimesh në shumë raste për çështje me interes strategjik për vendin, e janë të paktë deputetët që përballë faktorit ndërkombëtar, kanë qëndrime diametralisht të kundërta me ato që cilësohen si interesa madhore shtetërore.

5. Në pyetjen se sa aktivë janë deputetët me fjalime, iniciativa dhe aktivitete të ndryshme në takimet ndërkombëtare, subjektet e intervistuar shprehin mendimin se deputetët nuk janë aktivë sa duhet dhe shkaqet për mosaktivitetin e tyre janë të ndryshme. Psh. Gazmend Aliji mendon se **“deputetët, në shumicën e rasteve, tregojnë interesim për kyçjen e tyre aktive me diskutime dhe propozime të ndryshme, por zakonisht, propozimet, sidomos të deputetëve të opozitës, që janë më të mira e plot me ide kreative, përfundojnë aty ku kanë filluar, sepse pozita imponon vetëm idetë e veta, edhe pse të njëjtat nuk janë as të mira, as reale. Por si zakonisht në vendin tonë, pozita imponon vetëm agjendën e saj.”** Meral Ferati thotë se **“janë të paktë ata deputetë që shquhen me fjalime, iniciativa dhe aktivitetet të ndryshme në takimet ndërkombëtare. Shumica, fatkeqësisht, janë jo aktiv dhe mjaftohen vetëm me pjesëmarrje pasive në konferencat ose takimet e ndryshme, qoftë të karakterit multilateral ose bilateral.”** Ndërsa Pançe Minov thekson se **“për shkak Pandemisë nga COVID-19, deputetët marrin pjesë në konferenca dhe takime virtuale. Ka mjaft video-konferenca dhe mjaft interes për të njëjtat. Sa të mundësoj situata, takimet do të vazhdojnë si më parë me prezence fizike. Edhe përkundër situatës me Pandeminë, deputetët fuqishëm angazhohen për realizimin e marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore dhe për politikë rajonale miqësore, si dhe angazhohen për kapërcimin e të gjitha çështjeve të hapura që mund të paraqesin pengesë për integrimin e plotë të vendit tone në Unionin European”.**

Pra, mund të konstatojmë se edhe në këtë rast, aktivizmi i deputetëve lë shumë për të dëshiruar, qoftë për shkak të demoralizimit të opozitës kur idetë e tyre nuk merren parasysh nga shumica parlamentare, qoftë për faktin se në shumë raste, deputetët pjesëmarrës në konferenca të ndryshme, mjaftohen vetëm me praninë e tyre fizike (apo online tani në kushte pandemie), pa sjellë ndonjë diskutim me vlerë që do t'i ndihmonte procesit. Sigurisht që ka edhe përjashtime nga ky konstatim.

6. Sa i përket grupeve për bashkëpunim të Kuvendit, shumica e deputetëve theksojnë dhe pajtohen se këta grupe janë të mjaftueshme për bashkëpunim, por të njëjtit nuk zhvillojnë aktivitete sa duhet. Meral Ferati shpreh mendim se : **“Grupet Parlamentare të Miqësisë janë të mjaftueshme. Ka mbi 50 grupe të tilla për bashkëpunim, që përfshijnë shumicën e vendeve të botës. Sa i përket aktiviteteve të këtyre grupeve, vërehet mungesa e plotë e aktiviteteve.**

Mungojnë iniciativat dhe aktivitetet për bashkëpunim. Këto grupe janë një mundësi shumë e mirë që RMV të zë miq të shumtë në arenën ndërkombëtare, por kjo gjë fatkeqsisht nuk ndodh, sepse nuk ka interesim dhe mungojnë aktivitetet në këtë drejtim.” Ndërsa Ane Llashkoska thotë se **“aktivitetet e Grupeve të Miqësisë me Parlamentet e vendeve tjera nuk janë të mjaftueshme”**.

Mund të konstatojmë se ka grupe të mjaftueshme për bashkëpunim me parlamentet e vendeve të tjera, por të njejtat nuk zhvillojnë sa duhet aktivitete për të qenë faktor i rëndësishëm në diplomaci, e jo shumë herë jo për faj të anëtarëve të këtyre grupeve.

7. Pyetjes se si ndikoi dhe a mendoni se do ndryshojë edhe diplomacia në të ardhmen si pasojë e Pandemisë nga Covid 19, të intervestuarit u përgjigjen se pandemia ka ndikuar mjaft në punën e Parlamentit dhe se aktivitetet diplomatike që janë zhvilluar në këtë periudhë , kanë qenë tërësisht virtuale. Meral Ferati thotë se: **“Pandemia nga Covid 19, ashtu siç ndikoi në të gjitha sferat e jetës së shoqërisë dhe në mënyrën e funksionimit të institucioneve të shtetit, gjithsesi ka ndikuar shumë edhe në diplomaci, duke e penguar të zhvillohet si më parë, me takime të drejtpërdrejta, organizimet e konferencave të ndryshme me pjesëmarrje të drejtpërdrejta e kështu me rradhë. Në anën tjetër, Pandemia zhvilloi një lloj tjetër të diplomacisë, atë të ONLINE-Diplomacisë, e mendoj se kjo formë e diplomacisë do të zhvillohet edhe më shumë edhe në të ardhmen.”** Gazmend Aliji për ndikimin e Pandemisë në diplomacinë parlamentare shpreh këtë mendim se **“është e vërtetë që pandemia arriti që të ngadalsojë aktivitetet diplomatike në nivel botëror, e njehta ndodhi edhe me diplomacinë e vendit tonë. Vendi ynë, shume kohë mbeti pa përfaqësim në vendet me ndikim në politikën ndërkombëtare, kështu që pasojat i shohim çdo ditë te ne dhe në mbarë botën. Unë mendoj që bota pas kësaj pandemie, sigurisht më nuk do të jetë e njehta, kurrë më nuk do të jetë si ka qenë. Kjo padyshim duhet të shoqërohet edhe me mënyrën se si një vend zhvillon diplomacinë e cila gjithashtu, qartë do të ndryshojë”**. Ndërsa Ane Llashkoska mendon që **“Pandemia ndikoi negativisht edhe në Diplomacinë Parlamentare. Marrë parasysh ndikimin e pushtetit ekzekutiv që ka ndaj parlamentit dhe sjelljes injoruese të qeverisë ndaj Parlamentit, nuk pres se do ndryshojë ndonjë gjë edhe në të ardhmen”**. Nga ana tjetër Liman Avdiu mendon se **“ Pandemia (Covid-19) ka ndikuar shumë në aktivitetet ndërkombëtare dhe diplomatike të Parlamentit, sepse ka pamundësuar mbajtjen e seancave, konferencave, mbledhjeve,**

takimeve me prezencë fizike dhe këto janë mbajtur me Webinar (Videokonferenca online) dhe njohuritë jo të mjaftueshme IT të disa deputetëve, kanë qenë pengesë për realizimin e këtyre aktiviteteve.”

Pra mund të konstatojmë se Pandemia me Covid 19, në fakt hapi një dritare të re edhe për parlamentin e RMV-së sa i përket përdorimit të “Diplomacisë Online”. Kjo dritare duhet shfrytëzuar edhe në të ardhmen, sepse një mënyrë e tillë komunikimi, do të ulte ndjeshëm harxhimet e deputetëve për pjesmarrje në aktivitete me prani fizike, do të thjeshtëzonte dhe përshpejtonte komunikimin mes anëtarëve të grupeve të ndryshme të miqësisë me Parlamentet e vendeve të tjera, duke i kthyer kështu deputetët në aktorë të rëndësishëm edhe në zhvillimin e diplomacisë.

8. Pyetjes së fundit se sa është e përgaditur RMV për diplomacinë digjitale në të ardhmen, përafërsisht të gjithë subjektet e intervistuar, edhe pse me dallime të lehta shkaku i proviniencave politike, theksojnë se RMV nuk bën sa duhet në këtë drejtim ose duhet punuar shumë në këtë drejtim. Meral Ferati mendon që **“RMV, si për çdo gjë tjetër që s’është e përgaditur, nuk është e përgaditur edhe për diplomacinë digjitale. Për t’u ndryshuar kjo gjë dhe për të qenë të përgaditur për sfidat e së ardhmes, në RMV duhet ndryshuar shumë gjëra, duke filluar nga ndryshimi i mendësisë partizane në favor të profesionalizimit, të kuptuarit se diplomacia të ndihmon shumë në vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe krijimit të miqësive të reja dhe se të jesh deputet do të thotë se je aty për t’i përfaqësuar qytetarët e jo vetveten ose interesat personale.”** Ndërsa Ane Llashkoska ndan bindjen se **“nëse ka vullnet të mire dhe përkushtim, mund të kemi sukses në diplomacinë digjitale”**, kurse Pançe Minov thekson se **“RMV deri diku është e përgaditur për diplomaci digjitale, por ka mjaft punë rreth aspektit teknik. Rreth kësaj duhet ende të sofistikohet”**. Në anën tjetër Gazmend Aliji shpreh këtë mendim: **“Në qoftë se qëndron teza se bota më nuk do të jetë si më parë, e ndryshimi rrënjësor ka nisur që në fillim të vitit 2020, atëherë mendoj se edhe Maqedonia e Veriut, do të duhet të ndryshojë shumë gjëra, e më kryesorja e që duhet bërë shpejt, është që të digjitalizohet si e tërë bota, nëse do të hecë në hap me kohën”**.

Nga përgjigjet e subjekteve, konstatojmë se deputetët vlerësojnë se është koha që të përfshihen më aktivisht në diplomacinë e re digjitale që imponon koha, por për momentin Kuvendi gjatë periudhës fillestare të pandemisë, u tregua se nuk është i përgatitur teknikisht për këtë sfidë të re, e kjo duhet ndryshuar urgjentisht.

PËRFUNDIMI DHE KONKLuzionET

Korniza për bashkëpunim ndërkombëtar të Parlamentit të RMV në aspektin formal, është mirë e organizuar, por ajo që i mungon, është veprimi. Nga ajo që shqyrtuam në këtë punim, vërehet se shumë grupe të miqësisë dhe disa nga delegacionet për bashkëpunim, nuk janë aktivë sa duhet, madje një pjesë e grupeve të miqësisë ekzistojnë formalisht vetëm në letër.

Përveç mos interesimit të anëtarëve të delegacioneve apo grupeve për miqësi, në këtë mungesë aktiviteti, ndikojnë edhe rrethana të tjera e që kanë të bëjnë me mospasjen e pavarësisë financiare të Parlamentit, mospasja e traditës diplomatike, problemet e brendshme dhe një sërë problemesh të tjera që e karakterizojnë vendin tonë.

Diplomacia Parlamentare është shumë e nevojshme për vendin. Nevojitet vetëm më shumë angazhim dhe deputetë që njohin dhe e kuptojnë rëndësinë e diplomacisë. Në rrethanat tona, Parlamenti do t'i dilte në ndihmë të madhe Diplomacisë Tradicionale që udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Nevojitet bashkëpunim më i ngushtë i Parlamentit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, për t'i koordinuar aktivitetet diplomatike. Maqedonia e Veriut, si vend i vogël, në arenën ndërkombëtare duhet t'i shfrytëzojë të gjitha kapacitetet e saj diplomatike, përfshirë edhe Diplomacinë Parlamentare. Diplomacia Parlamentare, për dallim nga Diplomacia "Zyrtare", është më gjithëpërfshirëse sepse përfshin të gjithë spektrin politik të vendit dhe jo vetëm atë të qeverisë. Kjo duhet të shihet si përparësi dhe t'i jepet më shumë hapësirë veprimi.

Diplomacia Parlamentare duhet të jetë ndër prioritetet kryesore të Parlamentit. Të jesh aktiv në forumet parlamentare ndërkombëtare, sjell benefite të shumta. Këto forume parlamentare nxisin debatin publik mbi çështjet diplomatike globale, rajonale dhe ndërfqinjësore. Në themel të këtyre forumeve ndërkombëtare qëndron tradita demokratike. Kjo traditë mundëson edhe shkëmbimin e përvojave, ideve, bashkëpunimin dhe iniciativat e përbashkëta.

Angazhimi më i madh i parlamentit në arenën ndërkombëtare është në të mirën e qytetarëve, sepse bashkëpunimi dhe iniciativat e përbashkëta, sjellin vetëm mundësi për zgjidhje të shumë problemeve me të cilët ballafaqohet vendi, si në aspektin ndërkombëtar, po ashtu edhe në aspektin e brendshëm. Nga gjithë kjo konstatojmë se, mundësitë dhe dobitë nga diplomacia parlamentare janë të shumta në krahasim me rreziqet dhe mangësitë. Rreziqet eventualisht mund të paraqiten kur problemet e brendshme të natyrave të ndryshme barten jashtë, ndërsa nga ana

tjetër, diplomacia parlamentare mund të ndihmojë pikërisht edhe në këtë drejtim, duke zgjidhur edhe problemet e brendshme, qoftë të natyrës politike ose edhe të problemeve që kanë karakter ndëretnik.

Krejt në fund, bazuar edhe në aspektet teorike të literaturës që hulumton këtë sferë dhe në bazë të hulumtimit që është zhvilluar për këtë punim e që ka të bëjë me aktivitetet diplomatike të parlamentit të RMV-së, si dhe nga intervistat e realizuara me subjekte që janë drejtpërdrejtë të angazhuar në diplomacinë parlamentare, mund të konkludojmë se:

- Parlamenti luan rol të rëndësishëm në diplomaci dhe në krijimin e urave të bashkëpunimit e miqësisë midis vendeve të ndryshme, qoftë në aspektin bilateral, apo në atë multilateral.
- Diplomacia Parlamentare përfshin në vete të gjithë spektrin e shoqërisë së një vendi, spektrin politik, pozitë-opozitë, spektrin etnik, shqiptar-maqedonas-të tjerë dhe gjitha aspektet tjera të shtetit, gjë që paraqet një përparësi të madhe për një vend siç është RMV.
- Roli aktiv i Parlamentit në diplomaci, është më se i nevojshëm për shtetet e vogla siç është RMV, shtetet që janë në zhvillim dhe që duan një vend të respektuar në arenën ndërkombëtare.
- Në Diplomacinë Parlamentare shkëmbimi i përvojave, ideve, bashkëpunimi dhe iniciativat e përbashkëta, sjellin vetëm mundësi për zgjedhje të shumë problemeve me të cilët ballafaqohet vendi, si në aspektin ndërkombëtar, po ashtu edhe në aspektin e brendshëm.
- Fuqizimi i rolit të parlamentit në diplomaci ndihmon shumë diplomacinë “tradicionale” të vendit.
- Parlamenti duhet të luaj rol më aktiv në diplomaci, e marrë parasysh sfidat e reja globale, duhen bërë përpjekjet maksimale edhe në aftësimin e të gjitha kapaciteteve teknologjike dhe kuadrovike, përfshirë administratën e Kuvendit dhe vetë deputetët, në përqafimin e teknologjive të reja për mundësinë e sendërtimit të diplomacisë digjitale.

BIBLIOGRAFIA

BURIMET DHE LITERATURA:

- B.Reka, B.Bashota, Y.Sela, *Marrdhëniet Ndërkombëtare*, Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, Shkup, 2016
- Charles Chatterjee, *International law and diplomacy*, Routledge, London, 2010
- Clive Archer, *International Organizations-Third Edition*, Routledge, London, 2001
- G.R. Berridge, *Diplomacy: Theory and Practice, fifth edition*, Palgrave Macmillan, UK, 2015
- Henry Kissinger, *Diplomacia*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999
- Jonuz Abdullahi, *Politika dhe politikat publike*, Botimi i tretë, Arbëria Design, Tetovë, 2016
- J.Samuel Barkin, *International Organization: Theories and Institutions*, Pallgrave Macmillan, New-York, 2006
- Kushtetuta e RMV-së
- Nathalie de Grove-Valdeyron, Said Hamdouni, *Institucionet Ndërkombëtare dhe Komunitare*, Congress Service Center, Shkup, 2006
- Olivier Costa, Clarissa Dri and Stelios Stavridis, *The Role of the Inter-parliamentary Institutions*, Palgrave Macmillan, UK, 2013
- Rregullorja e punës së Parlamentit të RMV-së
- Stelios Stavridis, Davor Jančić, *Parliamentary Diplomacy in European and Global Governance*, E.J Brill, Leiden, 2017
- Veton Latifi, *Negocimi si teknikë parësore për zgjidhjen e konflikteve: Zhvillimi i Negociatave 2*, Instituti i Ohrit, Shkup, 2007
- Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2007

DOKUMENTE DHE RAPORTE:

- A.Azizi, shënim ligjrate, -“Institucionet Ndërkombëtare”, Tetovë, 15. Maj. 2021
- www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2018- 31.12.2018
- www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 1.1.2019- 31.12.2019
- www.sobranie.mk- “Raporti Vjetor për punën e Parlamentit të RMV-së” për periudhën 4.8.2020- 31.12.2020
- <http://archive.ipu.org/splz-e/sp-conf05/involvement-rpt.pdf>, - IPU, ‘Parliamentary Involvement in International Affairs’, “Raporti i Konferencës së dytë Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve” (New York, 7-9 Shtator 2005)
- <https://www.sobranie.mk/sessiondetails.aspx?sessionDetailsId=7bccdc8c-4d52-4572-8ffa-c74c1e29b9d1&isNew=undefined>, – “Stenogrami i Seancës së Parlamentit të RMV-së”, mbajtur më 4, shtator, 2013

REFERENCA DHE MATERIALE TË SHFRYTËZUARA NGA INTERNETI:

- <https://apf.francophonie.org/-Les-membres-.html>
- <https://www.cei.int/parliamentary-dimension>
- https://www.competition.rspcsee.org/en/About_SEECP_PA
- <https://www.ipu.org/about-us>
- <https://www.europarl.europa.eu/delegations/en/d-mk/about/introduction>
- <https://mfa.gov.mk/mk/page/37/europe/ambasadi>
- <https://www.oscepa.org/en/about-osce-pa/parliamentary-dimension-of-the-osce->
- <https://pace.coe.int/en/pages/representation>
- <https://www.pam.int/default.asp>
- <https://www.sobranie.mk/pg-2020-2024.nspix>
- <https://www.sobranie.mk/rabotni-tela-2020-2024.nspix>
- [http://shtetiweb.org/2014/08/22/risi-ne-diplomacine-parlamentare/-](http://shtetiweb.org/2014/08/22/risi-ne-diplomacine-parlamentare/) Jorgji Kote, “Risi në diplomacinë parlamentare”